

# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6237  
E enjte, 11 shkurt 2021  
çmimi 0.40 €

Katër të vdekur, 221 të shëruar dhe 307 raste të reja me Covid Faqë 6



DHOMAT E SPECIALIZUARA KANË NDRYSHUAR ORARIN E MBAJTJES SË SEANCËS SË RADHËS NDAJ ISH-DREJTUESVE TË UÇK-së Faqë 4-5


## SPECIALJA SHTYN SEANCËN NDAJ ISH-KRERËVE TË UÇK-së



Gjykata Speciale ka ndryshuar kalendarin e mbajtjes së seancës ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Seanca e tretë në lidhje mbi ecurinë e çështjes ndaj ish-krerëve të UÇK-së që ishte paraparë të mbahet sot (e enjte) nga ora 11:00 eشتë shtyrë për të martën, më 16 shkurt, në të njëjtën kohë. Specialja nuk ka dhënë shumë detaje përvimin e shtyrjes së kësaj seance, ndërsa Adil Behramaj, ish-këshilltar i ish-presidentit Hashim Thaçi, ka thënë se shtyrja ka ndodhur përkalkime politike

## KOSOVA KA DËSHTUAR NË DIPLOMACINË EKONOMIKE

Ministria e Punëve të Jashtme ka dështuar në diplomacinë ekonomike, përkatësisht në emërimin e atashevë ekonomikë të cilët do të lobonin për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës, përtërheqinë e investitorëve të huaja, si dhe përkrijimin e marrëdhënieve ekonomike me shtetet e zhvilluara. Kështu kanë thënë përgazetën "Epoka e re" ekspertë të fushës së ekonomisë, por edhe përfaqësues të bizneseve. Bashkëpunëtori i lartë përhulumtime në Institutin "Riinvest", Pëllumb Çollaku, ka thënë se mungesa e atashevë ekonomikë vjen për shkak të mospërvjøsjes diplomatike të Kosovës. Ndërsa drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, ka thënë përgazetën "Epoka e re" se shteti i Kosovës ka dështuar në diplomacinë ekonomike për shkak të mosemërimit të atashevë ekonomikë në misionet diplomatike Faqë 8-9



## Kryediplomatja shqiptare i kërkon Sllovakisë hapjen e një zyre ndërlidhëse për Kosovën në Bratislavë Faqë 5



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



## OPINION

KOSOVA, KUBËZ E MUNGUAR NË MOZAIKUN POLITIK TË NDRYSHUAR TË BALLKANIT, DREJT TË SË MAJTËS F. 11

Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA



## AKTUALE



KURTI: ARBEN XHELADINI DHE MON BALAJ JANË DËSHMORË TË VULLNETIT TË POPULLIT PËR LIRI F. 6

LIGJI PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE SË SHPEJTI DO TË PROCEDOHET PËR MIRATIM NË QEVERI F. 6

## AKTUALE

QEVERIA NDAN 579 345 EURO PËR INVALIDËT E LUFTËS SË UÇK-së F. 5

ZYRTARËT E ORGANIZATAVE BUXHETOKE TRAJNOHEN PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE TË FINANCAVE PUBLIKE F. 9

INDEP-i: SUBJEKTET POLITIKE PO INJOROJNË TË DREJTAT E KONSUMATORËVE F. 9

**RENOVA**  
PUTZ  
Makedoni Xhepcisht-Tetovë Curë-Ferizaj Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289  
E-mail: renova@mt.net.mk

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADE

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.  
DEGA KOSOVO  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website, Marketing...

## BE-ja e ndarë për idenë e 'pasaportës së vaksinimit'

**BRUKESEL, 11 SHKURT** - Vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE) mbesin të ndara lidhur me idenë e një "pasaporte të vaksinimit". Vendet bregdetare të BE-së po e mbështesin një ide të tillë për shkak se një pjesë e ekonomisë së tyre varet nga turizmi. Muajin e kaluar Greqia ka bërë thirrje që Komisioni Evropian të lejojë që "certifikat e vaksinës" të përdoren për udhëtime në BE. Të hënën ky vend nënshkroi një marrëveshje me Izraelin për ta mundësuar udhëtimin e personave të vaksinuar. Diskutimet brenda bllokut 27 anëtarësh janë duke u zhvilluar për rregullat e përbashkëta mbi të dhënat e pacientëve dhe njohjen e certifikatave të vaksinave. Ende

nuk ka një qëndrim të përbashkët se çfarë të drejtë mund të sigurojë një certifikatë e tillë.

Spanja, e cila është shumë e interesuar për të pasur turistë, ende nuk ka lëshuar një "pasaportë të vaksinimit". Ministrja e Jashtme, Arancha Gonzalez Laya, e ka vlerësuar një ide të tillë si "një element shumë i rëndësishëm për të garantuar një kthim të sigurt të lëvizjes". Edhe Italia beson se një dokument i tillë mund ta hapë rrugën e kthimit në aktivitete normale. Suedia dhe Danimarka kanë shpallur tashme certifikatat elektronike, në bazë të të cilave mund të bëhen udhëtimet jashtë vendit. Në Danimarkë, për shembull, ata që



kanë këto dokumente mund të darkojnë në restorante. Organizata Botërore e Shëndetësisë e mbështet mundësinë e certifikatave të vaksinave, por ka shprehur

kritika që ato të përdoren si kusht për ta mundësuar udhëtimin. "Nuk kanë të gjithë qasje në vaksina. Pastaj, ne nuk e dimë nëse ato parandalojnë transmetimin", ka thënë ministri

i Shëndetësisë, Olivier Veran, në janar. Gjermania është, gjithashtu, kundër që një pakicë e njerëzve të vaksinuar të gjëzojnë privilegje të cilat u ndalohen të tjerëve. "Nëse një restorant dëshiron të hapet vetëm për njerëzit e vaksinuar, do të ishte e vështirë të ndalojet sipas ligjeve aktuale", ka thënë ministrja e Drejtësisë, Christine Lambrecht.

Në Bashkimin Evropian (BE) janë vaksinuar me dy doza të vaksinës vetëm 5.5 milionë njerëz, raporton "AFP". Kjo përbën vetëm 1.2 për qind të popullsisë. Të paktën 12.8 milionë njerëz apo 2.9 për qind e popullsisë së bllokut kanë marrë një dozë, e cila siguron imunitet të pjesshëm ndaj Covid-19.

## Gjermania pritet ta zgjasë masën e izolimit

**BERLIN, 10 GUSHT** - Gjermania pritet ta zgjasë masën e izolimit të pjesshëm deri në fillim të muajit mars, pavarësisht pse shkalla e infektimit është duke rënë në shtetin me ekonominë më të madhe në Evropë.

Kancelarja gjermane Angela Merkel dhe kryetarët e 16 landeve do të mbledhën më 10 shkurt për të diskutuar për strategjinë e së ardhmes teksa rriten thirrjet nga bizneset për t'i lehtesuar masat e izolimit. Merkeli raportohet se preferon t'i zgjasë masat të cilat janë në fuqi prej muajit nëntor dhe të

cilat janë ashpërsuar në mesin e muajit dhjetor. "Ne nuk do të fitonim asgjë nëse do ta largonim izolimin para kohës", u ka thënë Merkel pjesëtarëve të Partisë së saj Demokristiane (CDU), kanë deklaruar pjesëmarrësit e këtij takimi. Ajo besohet të ketë bërë edhe paralajmërimë se shkalla e infektimit mund të rritet sërisht nëse izolimi hiqet shpejt. Qeveria ka vënë synim që duhet të raportohen 50 raste për 100 000 banorë, në mënyrë që të hiqet izolimi. Aktualisht në këtë shtet raportohet për 73 persona në 100 000 banorë,

gati gjysmë më pak sesa në mesin e muajit janar. Megjithatë, shkalla e vdekshmërisë vazhdon të mbetet e lartë, rreth 500 në ditë. Ky debat vjen teksta Evropa vazhdon të përballet me vështirësi për vaksinim të shpejtë, në mungesë të vaksinave. Variantet që përhapen më lehtë, në anën tjetër, kërcenojnë përparimin e vogël që është bërë kundër pandemisë. Në mori studimesh kanë gjetur se një numër vaksinash janë më pak efektive kundër të ashtuquajtur variant jugafrikan i koronavirusit.



## Deputetët evropianë miratojnë paketën për rimëkëmbje

**STRASBURG, 10 GUSHT** - Deputetët e Parlamentit Evropian kanë miratuar planin për rimëkëmbje të këtij blloku, duke ua hapur rrugën vendevë anëtare që të kenë qasje në gati 700 miliardë euro si kredi apo grante, me qëllim të tejkalimit të dëmeve ekonomike që ka shkaktuar pandemia.

Grantet - rreth 300 miliardë euro - do të ndahen për investime dhe reforma, me qëllim të stimulimit të ekonomive të 27 vendevë anëtare, transmeton "DPA". Për të fituar qasje në të holla, shtetet e BE-së duhet t'i



dorëzojnë planet e tyre për shpenzime deri më 30 prill. Komisioni Evropian dhe vetë shtetet e BE-së më pas duhet të pajtohen për secilin plan. Në votimin e të martës, rezultatet

e të cilët janë publikuar të mërkurën, deputetët e Parlamentit Evropian kanë miratuar planin me shumicë votash. Përgjatë debatit, deputeti

Siegfried Muresan, që ka qenë i përfshirë në negociata, ka thënë se fondet duhet të shfrytëzohen për t'i modernizuar ekonomitë e shteteve. "Këto para nuk duhet të përdoren për shpenzime të zakonshme të buxhetit, por për investime dhe reforma", ka thënë ai.

Shtetet anëtare ende duhet ta pranojnë zyrtarisht paketën, mirëpo nuk pritet të ketë pengesa në këtë aspekt. Problemi më i madh do të jetë miratimi i vendimit që i mundëson bllokut evropian t'i huazojë paratë nëpër tregje.

Shumica e paketës së rimëkëmbjes besohet se do të financohet në këtë mënyrë. Kur ky dokument të ratifikohet dhe të miratohen planet kombëtare, Komisioni Evropian duhet t'i ndajë paratë për qeveritë, mirëpo ato nuk pritet të dorëzohen për disa muaj, marrë parasysh procedurat komplekse. Plani i BE-së për rimëkëmbje do t'i mbulojë masat që zbatohen në periudhën shkurt 2021 - gusht 2026. Projektet që janë miratuar para planit për rimëkëmbje do të mund të financohen po ashtu.

## Presidentja e Komisionit Evropian pranon vonesat për vaksinat kundër Covidit

**BRUKESEL, 10 SHKURT** - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka pranuar gabimet në strategjinë për të siguruar vaksina të mjaftueshme për 447 milionë qytetarët e Bashkimit Evropian, teksha është përgjithshëm që kritika nga ligjvénësit lidhur me menaxhimin që i ka bërë

blloku evropian vaksinimit. "Ne ende nuk jemi ku duam të jemi. Kemi qenë të vonshëm në autorizim. Ne kemi qenë shumë optimistë kur kemi pasur të bëjmë me prodhim masiv dhe, ndoshta, kemi pasur shumë vetëbesim se ajo që e kemi porositur mund të dërgohej në kohë", ka thënë von der Leyen para

Parlamentit Evropian më 10 shkurt. Megjithatë, politikania gjermane ka mbrojtur qasjen e përgjithshme të bllokut evropian përluftën kundër pandemisë përmes një planit të përbashkët për vaksina në të 27 vendet. Teksa Bashkimi Evropian tejkalon shifrën e 500 000 personave të vdekur me

koronavirus, Komisioni Evropian është duke u përballur me kritika për skemë të ngadalshme të vaksinimit, e cila mundësohen negociimin pëblerje të vaksinave në emër të të gjitha vendeve të BE-së. Shpërndarja e vaksinave është goditur edhe nga prodhuesit e vaksinave të cilët kanë përmendur kapacitetet dhe

furnizimet si arsyë për vonesa. Kompanitë "Pfizer" dhe "AstraZeneca" janë vetëm dy prej kompanive që kanë thënë se nuk do të mund të arrijnë pritshmëritë për prodhim të vaksinave për shkak të disa ndryshimeve që duhen bërë nëpër fabrikat e tyre, me qëllim të rritjes së kapacitetit të prodhimit në të ardhmen.

# Katër të vdekur, 221 të shëruar dhe 307 raste të reja me Covid

**PRISHTINË, 10 SHKURT (ER)** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit në vendin tonë kanë ndërruar jetë katër persona si pasojë e infektimit me Covid-19. Po ky institut ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur 307 raste të reja dhe janë shëruar 221 persona. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 1 787 mostra të marra nga ShSKUK-ja

dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 307 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 4 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Fushë-Kosovë 1 rast (58 vjeç), Malishevë 1 rast (63 vjeç), Prizren 1 rast (63 vjeç) dhe Suharekë 1 rast (58 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 63 089 raste nga 256 355 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 1 532 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 221 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të




shëruarve deri më sot është 54 661 raste, kurse numri i rasteve aktive është 6 896", ka njoftuar IKShPK-ja,

duke treguar numrin e rasteve të reja me Covid sipas komunave. "Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 128 raste, Prizren 34 raste, Gjakovë 17 raste, Fushë-Kosovë 16 raste, Pejë 16 raste, Podujevë 16 raste, Mitrovicë 12 raste, Gjilan 9 raste, Vushtrri 9 raste, Lipjan 8 raste, Istog 6 raste, Suharekë 6 raste, Malishevë 5 raste, Rahovec 5 raste, Dragash 4 raste, Drenas 4 raste, Ferizaj 4 raste, Deçan 2 raste, Obiliq 2 raste dhe me nga një rast komunat Hani i Elezit, Kamenicë, Kaçanik dhe Skenderaj", ka njoftuar IKShPK-ja.

## Klinika e Syve shton vëllimin e punës, ul referimet jashtë vendit

**PRISHTINË, 11 SHKURT (ER)** - Shërbimi Spitalor dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar se numri i rasteve të referuara nga Klinika e Syve në QKUK për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore ka rënë në më shumë se 50 për qind gjatë vittit 2020. Sipas ShSKUK-së, vitin e kaluar 190 patientë të cilët kanë pasur probleme të ndryshme shëndetësore me sy, të cilat nuk janë trajtuar në Kosovë, janë dërguar për shërim jashtë institucioneve publike shëndetësore. "Në vitin 2019 u referuan 469 raste, ndërsa në vitin 2018 ishin referuar 527 raste për shërim jashtë institucioneve publike shëndetësore. Pas blerjes së

aparaturës së re dhe pas trajnimeve të vazhdueshme që kanë ndjekur mjekët, në Klinikën e Syve gjatë vittit 2020 janë aktivizuar shërbime të reja shëndetësore. Për një vit mjekët specialistë të oftalmologjisë kanë kryer 126 operacione në segmentin e pasmë të syrit apo PPV (Pars Plana Vitrectomji), 37 intervenime me 'Laser Assisted DCR'- 'Dacryocystorhinostomy' (operim i kanalit të lotit me laser), 41 raste me 'Cross-Linking (CXL)' te rastet me keratokonus dhe 4 ndërhyrje me laserim te retinopatia te prematurët - ROP (ndërhyrje me laser te fëmijët e lindur para kohe, që kanë problem me enët e gjakut)", ka njoftuar ShSKUK-ja. Më herët, në pamundësi për t'i



marrë këto shërbime në QKUK, qytetarët e Kosovës janë detyruar të gjunjë zgjidhje jashtë institucioneve publike shëndetësore dhe në vendet e huaja, duke harxhuar mijëra euro.

## Shqipëri: Më 15 shkurt mbërrin sasia tjetër e vaksinave kundër Covidit



**TIRANË, 10 SHKURT (ER)** - Ministrja e Shëndetësisë në Shqipëri, Ogerta Manastirliu, në një konferencë me gazetarë, ka deklaruar se më 15 shkurt do të vijë ngarkesa tjetër me vaksinat kundër Covidit nga kompania "Pfizer". Ministrja ka theksuar se Qeveria e Shqipërisë ka mundur të sigurojë vaksina për 800 mijë qytetarë të cilët do të

vaksinohen hap pas hapi sipas strategjisë së ekspertëve. "Vaksina është arma më e fuqishme për ta kontrolluar pandeminë për të cilën, sa të njoitura, kemi aq dhe të panjohura. Është e rëndësishme që të dimë sa është numri i të prekurve. Qeveria ka siguruar nga 'Pfizer' dhe 'Covax' vaksina për 800 mijë qytetarë, ku përfshihen

grupet kryesore të rrezikut dhe prioritare dhe ne kemi filluar me ato që janë më të ekspozuarit e që janë mjekët, infermierët dhe epidemiologët. Kemi filluar me dozën e dytë të vaksinimit dhe vijojmë me rritjen e tyre pasi ju e dini tashmë se më 15 shkurt do të bëhet edhe mbërritja e dozave të tjera nga 'Pfizer', ka thënë Manastirliu.



### Valbon Krasniqi emërohet drejtor i ShSKUK-së

**PRISHTINË, 10 SHKURT (ER)** - Bordi Drejtues i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 10 shkurt 2021, në mënyrë unanim e ka votuar reportin e komisionit vlerësues, në bazë të të cilit drejtor i përgjithshëm i ShSKUK-së

emërohet dr. Valbon Krasniqi", ka njoftuar ShSKUK-ja. Krasniqi për disa muaj ka shërbyer ushtrues detyre i drejtorit të ShSKUK-së, pas largimit të Basri Sejdut nga kjo pozitë. Krasniqi me profesion është infektolog.



DHOMAT E SPECIALIZUARA KANË NDRYSHUAR ORARIN E MBAJTJES SË SEANCËS SË RADHËS  
NDAJ ISH-DREJTUESVE TË UÇK-SË

# Specialja shtyn seancën ndaj ish-krerëve të UÇK-së

Gjykata Speciale ka ndryshuar kalendarin e mbajtjes së seancës ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Seanca e tretë në lidhje mbi ecurinë e çështjes ndaj ish-krerëve të UÇK-së që ishte paraparë të mbahet sot (e enjte) nga ora 11:00 është shtyrë për të martën, më 16 shkurt, në të njëjtën kohë. Specialja nuk ka dhënë shumë detaje për vendimin e shtyrjes së kësaj seance, ndërsa Adil Behramaj, ish-këshilltar i ish-presidentit Hashim Thaçi, ka thënë se shtyrja ka ndodhur për kalkulime politike

**EPOKA ERE** Muhamet KOCI

**PRISHTINË, 10 SHKURT** - Gjykata Speciale ka shtyrë seancën e radhës për ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Seanca e tretë për ecurinë e çështjes ndaj ish-krerëve të UÇK-së, që ishte paraparë të mbahet sot (e enjte) nga ora 11:00, është shtyrë për të martën, më 16 shkurt, në të njëjtën kohë. Sipas njoftimit të lëshuar nga Specialja për shtyrjen e kësaj seance, kjo ka ndodhur për arsy organizative që, sipas tyre, lidhen edhe me mundësinë e pranisë së palës mbrojtëse në seancë. Ecuria e çështjes gjyqësore parashihet me rregullën 96 të Rregullores së

Procedurës dhe Provave të Dhomave të Specializuar të Kosovës.

Gjykata Speciale këtë shtyrje nuk e ka ndërlidhur me ndonjë ngjarje politike. Por, pas njoftimit për shtyrje, ka pasur zëra që kjo ka ndodhur për shkak të zgjedhjeve të parakohshme në Kosovë të cilat do të mbahen më 14 shkurt. Adil Behramaj, ish-këshilltar i ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se vendimi për shtyrje të seancës është kalkulum politik. Sipas tij, nuk është hera e parë që kjo gjykate bën politikë me këtë proces. "Që nga njoftimi i Zyrës së Prokurorit të Specializuar për dorëzimin e aktakuzës ndaj Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit, një praktikë e paprecedent në drejtësinë ndërkontinentare, deri

në vendimin e tashëm për shtyrjen e paraqitjes së tyre para Gjykatës Speciale, nga 11 shkurt më 16 shkurt, duket se nuk ka asnjë rastësi në sjelljen e kësaj gjykate me themeluesit e UÇK-së dhe themeluesit e shtetit të Kosovës. Me publikimin e njoftimit për ngritjen e aktakuzës ende pa u konfirmuar, Gjykata Speciale bëri gjyqit tre muaj pasi është dhënë procesverbali i terti i shtyrjes së zgjedhjeve, Gjykata Speciale bëri kalkulum politik", ka shkruar ai në profilin e tij në "Facebook".

Ai ka thënë se shtyrja është bërë me pretendimet se prania mediale e Thaçit dhe Veselit mund të ndikojë te votuesit në Kosovë. "Po i frikësohen paraqitjes së Hashim Thaçit e

Kadri Veselit edhe në Dhomat Speciale në Hagë. Po druhën që prania mediale njëditore e tyre ndikon te votuesit dhe ua prishë atyre skenarin politik, të cilin po përpilen ta jetësojnë në emër të drejtësisë. Kjo është dëshmi tjetër që largimi i tyre nga skena politike në emër të drejtësisë ishte dhe mbetet terti i sinkronizuar. Megjithatë, të drejtës së votimit nuk ua kanë mohuar dhe votat e tyre kanë arritur nga Haga në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Hashim Thaçi e Kadri Veseli dihet kënd e kanë votuar dhe dihet se kënd do të dëshironin që ta votonit edhe ju", ka shkruar Behramaj.

## Prokuroria insiston që gjykimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së të nisë në shtator

Prokuroria e Gjykatës Speciale në Hagë është duke vazhduar të insistojë me çdo kusht që gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së të nisë në shtator ani pse mbrojtja e të akuzuarve ka kërkuar më shumë kohë. Ashtu siç ka kërkuar gjykatesi francez i

procedurës paraprake, Prokuroria e Specializuar ka dërguar tanimë parashtresat për seancën e radhës. "SPO më parë i ka kërkuar gjykatesi të caktuar një datë gjyktimi jo më vonë se shtatori 2021 dhe mbi atë bazë tregoi gatishmëri dhe aftësi për ta siguruar materialin deri në korrik 2021 si pasojë e të cilit autorizimi gjyqësor për të prezantuar çdo material të mëtejshëm zakonisht do të hynte në fuqi", është thënë në parashtresat e Zyrës së Prokurorit.

Prokuroria insiston se fillimi i gjyqit tre muaj pasi është dhënë procesverbali i terti i shtyrjes së zgjedhjeve, Gjykata Speciale bëri kalkulum politik", ka shkruar ai në profilin e tij në "Facebook". Ai ka thënë se shtyrja është bërë me pretendimet se prania mediale e Thaçit dhe Veselit mund të ndikojë te votuesit në Kosovë. "Po i frikësohen paraqitjes së Hashim Thaçit e



dhe/ose sigurimit të njoftimit paraprak të prokurorisë, dëshmive dhe listave të ekspozimeve, është një standard i zbatuar zakonisht për raste komplekse ndërkombe, është thënë në parashtresat e Prokurorisë.

Prokuroria e Specializuar më tutje kundërshton të gjitha propozimet e mbrojtjes që gjyqi të nisë kah fundi i 2022-s apo fillimi i 2023-s. Ajo pretendon se avokatët në interpretimet e tyre kanë rrjedhur nga faktet reale për kohëzgjatjen e gjyqeve të tjera në tribunale ndërkombe. ZPS-ja ka theksuar se faktet e paraqitura nga mbrojtja paraqesin një studim akademik, në të cilin prezantohet kohëzgjatja e gjyqeve në tribunale ndërkombe, e ku llogaritet koha që nga ngritja e aktakuzës deri në nisjen e gjykimit. Prokurorët e Specializuar më tutje kundërshtojnë edhe argumentin tjetër të mbrojtjes e cila krahason kohën e kaluar në hetime nga organi ndjekës si dhe mbrojtja. "Më në fund, mbrojtja ka cituar gjatësinë e supozuar të hetimit të prokurorisë në mbështetje të parashikimeve të veta të hetimit paragjyqësor. Si fillim, kallëzuesi për pretendimin është i pavërtetë - gjatësia e supozuar e hetimit të ndjekjes penale është thjesht një vlerësim i përgjithësuar dhe i pasaktë bazuar në gjatësinë e institucionit që ka ekzistuar. Për

më tepër, argumenti rrjedh nga një premisë e rremë. Ndryshe nga SPO, mbrojtja nuk thirret për të kryer një hetim të gjerë për të identifikuar dhe më pas për t'i vendosur elementet e provave në lidhje me një numër të patreguar të ngjarjeve për një periudhë të gjatë, të gjitha në një standard të përmjet dyshimit të arsyeshëm. Në vend të kësaj thirret që t'i përgjigjet një distinimi", është thënë në parashtresën e Prokurorisë. Ditë më parë gjyqtari i procedurës paraprake në kuadër të Dhomave të Specializuar, Nicolla Goillou, ka refuzuar kërkesën e mbrojtjes së Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit përlirim nga paraburgimi. Më pas, avokatët e 4 të akuzuarve kanë apeluar vendimin në Gjykatën e Apelit në kuadër të Dhomave të Specializuar.

Të gjithë të akuzuarit, gjatë paraqitjeve të tyre në seancat e para gjyqësore, janë dekluarar të pafajshëm, duke hedhur poshtë të gjitha pikat e aktakuzës. Veprat që rëndojnë ndaj Thaçit dhe të tjerëve kanë të bëjnë me krimet luftë, ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme, zhdukjes me forcë të personave dhe përndekjes së tyre, të cilat, sipas Dhomave të Specializuar, janë kryer midis marsit 1998 dhe shtatorit të vitit 1999.

## Qeveria ndan 579 345 euro për invalidët e luftës së UÇK-së

**PRIŠTINË, 10 SHKURT** - Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve për nevojat emergjente për protezat e invalidëve të luftës së UÇK-së. Në njoftimin e bërë për media është thënë se me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës është aprovuar kërkesa e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së për ndarjen e mjeteve financiare në vlerën prej pesëqind e shtatëdhjetë e nëntëmijë e treqind e dyzetë e pesë euro (579

345 00 euro) për mbulimin e shpenzimeve për nevojat emergjente për protezat e invalidëve të luftës së UÇK-së.

Këto mjete do të shfrytëzohen vetëm për qëllime të specifikuara me kërkesën e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së. Në njoftimin e bërë për media është thënë se me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës është aprovuar kërkesa e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së për ndarjen e mjeteve financiare në vlerën prej pesëqind e shtatëdhjetë e nëntëmijë e treqind e dyzetë e pesë euro (579

Dala nga Lufta e UÇK-së - anëtar, dhe përfaqësues nga Shoqata e Invalidëve e Luftës së UÇK-së - anëtar.

Në njoftim është thënë se komisioni do ta monitorojet shpenzimin e mjeteve të ndara dhe do ta përgatisë raportin e detajuar për qeverinë. Gjithashtu, vendimi qeveritar ka rekomanduar që institucionet të ofrojnë zgjidhje të përhershme për invalidët e luftës së UÇK-së në pajtim me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 3 shkurt 2021.



## Kryediplomatja shqiptare i kërkon Sllovakisë hapjen e një zyre ndërlidhëse për Kosovën në Bratislavë

**TIRANË, 10 SHKURT (ER)** - Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë, Olta Xhaçka, e ka pritur të mërkurën në Tiranë homologun sllovak Ivan Korcok, me të cilin kanë diskutuar edhe për procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Xhaçka ka thënë se i ka

kërkuar ministrit të Jashtëm të Sllovakisë që të hapë një zyrë ndërlidhëse për Kosovën në Bratislavë si sinjal pozitiv përkrahje të procesit të vështirë të negociatave në mes të Prishtinës dhe Beogradit. "I propozova kolegut tim që të hapë një zyrë ndërlidhëse të

Republikës së Kosovës në Bratislavë, si një shenjë pozitive për mbështetje të procesit të vështirë të dialogut Kosovë - Serbi", ka shkruar Xhaçka në llogarinë e vet në "Twitter". Sllovakia është një prej pesë shteteve të BE-së që vazhdon të mos e njohë Kosovën shtet.



## Nasim Haradinaj mbetet në paraburgim

Paneli i Gjykatës së Apelit pranë Dhomave të Specializuar ka refuzuar apelin e Nasim Haradinajt kundër vendimit përmbytje të tij të mëtejshme në paraburgim. Ndërsa arsyetimet e Apelit është edhe pretendimi se Haradinaj ka zbuluar emrat e disa individëve të lidhur me konfidencialitetin e hetimeve

dhe ka inkuruar mediat të bëjnë të njëjtën gjë, e që tregon se gjyqtari i procedurës paraprake kishte vlerësuar se Haradinaj mund t'i vë në rrezik dëshmitarët e mundshëm përmes publikimit të informave konfidenciale. Nënkryetari i OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj, është arrestuar më 25 shtator të vitit të kaluar.

## Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve së shpejti do të procedohet për miratim në qeveri

**PRISHTINË, 10 SHKURT (ER)** - Ministri në detyrë i Drejtësisë, Selim Selimi, ka bërë me dije se Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve shumë shpejt do të procedohet për miratim në Qeverinë e Kosovës. "I lumtur që draftregullorja për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit shumë shpejt do të procedohet për miratim në qeveri. Kjo është edhe një prej mjetave të

shumta për ta luftuar korruptionin e nivelit të lartë nëpër institucione", ka shkruar Selimi në llogarinë e vet në "Facebook". Sipas Selimit, ky ligj do të mundësojë raportimin e çdo parregullsie apo shkeljeje për të cilën vihen zyrtarët në dijeni gjatë ushtrimit të detyrës. "Por, ligji si i vetëm nuk mund t'i përcaktojë të gjitha çështjet procedurale

dhe teknike. Risitë e këtij ligji do të mund të vihen në zbatim me miratimin e Rregullores për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, miratimi i së cilës avancon sundimin e ligjit, përafron legjisacionin vendor me atë të BE-së dhe kompleton infrastrukturën ligjore për trajtimin e rasteve të sinjalizimit" ka shkruar Selimi.



## Drejtimi euroatlantik i Kosovës dhe Malit të Zi, vendimtar për sigurinë në Ballkan

**PRISHTINË, 10 SHKURT (ER)** - Ministrja në detyrë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka pritur në takim lamtumirës ambasadorin e Malit të Zi, Ferhat Dinosha, i cili është në përfundim të misionit të tij në Kosovë. Temë kryesore e bisedës ishte vazhdimi i bashkëpunimit të ngushtë midis dy vendeve, ku Haradinaj-Stublla ka theksuar se mbarëvajtja e drejtimit euroatlantik të Kosovës dhe Malit të Zi është vendimtar për sigurinë dhe stabilitetin në Ballkan. "Diskutuan për situatën aktuale politike e të

sigurisë në vend dhe rajon dhe përaportet bilaterale midis Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së marrëdhënieve dhe bashkëpunimit midis dy vendeve. Thelbësor në këtë aspekt është vazhdimi i projekteve të përbashkëta ndërkufitarë dhe infrastrukturore siç është rruga Deçan-Plavë, që është potencial i zhvillimit ekonomik lokal dhe lidhjeve ndërkombëtare të rajonit", ka deklaruar ajo.

Kryediplomatja e Kosovës ka deklaruar se marrëdhënet në




mes të Kosovës dhe Malit të Zi

komuniteteve tona në vendet respektive. "Është e

rëndësishme që të rifunksionalizojmë Qendrën Zhvillimore të Malit të Zi në Prishtinë, që të jetë në shërbim të të gjitha shoqatave të përfaqësimit të Malit të Zi në Kosovë dhe rritjes së bashkëpunimit të ndërsjellë. Në të njëjtën kohë, diskutuan përsituatën në rajon. Potencova që Serbia duhet t'i dëgjojë thirrjet e përsëritura të Washingtonit për njohje reciproke, për t'i dhënë paqen e qëndrueshme rajonit dhe për të nisur një kapitull të ri të fqinjësise së mirë - me të gjithë, përfshirë Malin e Zi dhe Bosnjën", ka deklaruar Haradinaj-Stublla.

## Studentët e AAB-së marrin pjesë në garën e Universitetit të Harvardit

Ekipi pjesëmarrës i AAB-së në përbërje të studentëve Lirie Hoti, Enxhi Ballata, Leandrit Llunji e Dafina Ukaj e nën udhëheqjen e profesorëve Egzonis Hajdari e Skender Gojani, janë përzgjedhur përmes një konkursi publik, pas procedurave të testimit dhe intervistimit të aplikantëve për këtë garë", ka njoftuar AAB-ja



listimin zyrtar të pjesëmarrësve. Ekipi pjesëmarrës i AAB-së në

përbërje të studentëve Lirie Hoti, Enxhi Ballata, Leandrit

Llunji e Dafina Ukaj e nën udhëheqjen e profesorëve Egzonis Hajdari e Skender Gojani, janë përzgjedhur përmes një konkursi publik, pas procedurave të testimit dhe intervistimit të aplikantëve për këtë garë", ka njoftuar AAB-ja. Sipas këtij njoftimi, në edicionin e sivjetmë të garës HNMUN do të marrin pjesë mbi 1 000 delegatë nga 32 shtete të botës, ndërsa gara do të konsistojë në diskutimin e çështjeve të rëndësise së veçantë në botë dhe gjetjen e zgjidhjeve të ekilibruara dhe të integruese për to.

## Kurti: Arben Xheladini dhe Mon Balaj janë dëshmorë të vullnetit të popullit për liri

**PRISHTINË, 10 SHKURT (ER)** - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë homazhe te varri i Mon Balajt, e më pas te varri i Arben Xheladinit në Prishtinë. Me këtë rast, Kurti ka thënë se Moni dhe Arbeni janë dëshmorë të vullnetit të popullit për liri. "Pas homazheve në Besianë te Moni, ne erdhëm këtu te varri i Arbenit që, po ashtu, të bëjmë homazhe dhe të vendosim lule të freskëta.

fillimisht bënë homazhe në Podujevë te varri i Mon Balajt, e më pas te varri i Arben Xheladinit në Prishtinë. Me këtë rast, Kurti ka thënë se Moni dhe Arbeni janë dëshmorë të vullnetit të popullit për liri. "Pas homazheve në Besianë te Moni, ne erdhëm këtu te varri i Arbenit që, po ashtu, të bëjmë homazhe dhe të vendosim lule të freskëta.

Arbeni dhe Moni janë dëshmorë të vullnetit të popullit për liri, i cili është i pandalshëm pavarësish prej pengesave dhe vështirësive. Besnikeria e LV-së ndaj asaj demonstrate dhe këtyre dëshmorëve është thellë në organizatën tonë, në mendjen dhe zemrën e secilit aktivist", ka thënë Kurti.



Aktivitetet e partive politike në kuadër të fushatës së zgjedhjeve të 14 shkurtit

## Kurti: Më 14 shkurt do të vendosim për qeverisjen e re

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidati për kryeministër, Albin Kurti, është shoqëruar sërisht nga bashkëshortja e tij, Rita Augestad Knudsen, gjatë një tubimi të mbajtur në Prizren. Bashkëshortja e ka shoqëruar Kurtin në tubime edhe gjatë ditës së martë. Kurti në Prizren ka thënë se më 14 shkurt do të ndodhë ndryshimi i cili nuk do të diskriminojë askënd. "Pranvera po vjen me nxitim. Falënderojmë qytetarët që po na bashkohen në ecjen tonë. Më 14 shkurt do të vendosim për qeverisjen e re që nuk diskriminon askënd", ka thënë Kurti. Në Prizren ka qenë e pranishme edhe kandidatja për president nga radhët e Vetëvendosjes, Vjosa Osmani. Pas Prizrenit, Lëvizja Vetëvendosje ka mbajtur tubim elektoral edhe në Klinë.

**Hoti: Shumica absolute e do Kosovën në NATO dhe jo me shami të kuqe të orientuar kah Lindja**

Kandidati për kryeministër nga LDK-ja, Avdullah Hoti, në tubimin e sotëm në Viti ka thënë se "Zoti e ka bo verë", duke u shprehur i bindur në fitore. "Prej sot mbetet veç me e shpall që zgjedhjet janë të kryera më 14 shkurt dhe ne duhet të festojmë

nuk janë zgjedhje të thjeshta për të formuar një shumicë parlamentare. Janë zgjedhje për ta ruajtur orientimin properëndimor të shtetit të Kosovës. Unë besoj se do të fitojmë, sepse shumica absolute e njerëzve në Kosovë e do Kosovën në BE dhe NATO sesa që e do Kosovën me shami të kuqe dhe të orientuar kah Lindja", ka thënë Hoti.

**Hoxhaj merr mbështetje në garën për kryeministër nga zyrtari i lartë i Pakistanit**

Mushahid Hussain Syed, kryetar i Komitetit për Punë të Jashtme të Senatit të Pakistanit, i ka dhënë mbështetje Enver Hoxhajt të PDK-së në garën për kryeministër të Kosovës. Ai e ka quajtur Hoxhajn burrështetas i madh të Ballkanit. "Ai (Enver Hoxhaj) është një mirëpritës i ngrohtë. Ai është burrështetas për të ardhmen, për Kosovën dhe popullin e saj, për Ballkanin dhe se si ky rajon dhe shteti i tij mund të bashkëveprojë me komunitetin ndërkombëtar, në një botë gjithnjë në lëvizje. Kosova ka nevojë për një udhëheqje të re, për një lidership të dëshmuar, që është i testuar, e cila është e parapërcaktuar për



**Haradinaj: Më 14 është referendumi për AAK-në dhe Kosovën në NATO**

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe kandidati për president, Ramush Haradinaj, ka mbajtur një tubim parazgjedhor në vendlindjen e tij, Deçan. Gjatë fjalimit të tij, Haradinaj ka prezantuar programin e AAK-së për ekonominë, duke u bërë thirrje mërgimtarëve të investojnë në Kosovë për shkak të rënies nga pandemia. "Ne kemi përgatitur një plan. Ta konsolidojmë siguri, shtetin ligjor që garant që nuk rrezikohet as nga brenda, por as prej jashtë e që nuk bëhen eksperimente në këtë shtet. Në shtet kërkohen njerëz seriozë, për këtë e kemi marrë përsipër,

siguria rendi dhe ligji, e në Kosovë kemi me bo shtet të sigurt, por mos me pas mundësi askush me rreziku. Kemi plot kategori që nuk janë mjaftueshëm në pozitë, do të kujdesem për të gjitha kategoritë", ka thënë Haradinaj. Më tutje, Haradinaj para deçanasve ka thënë se më 14 shkurt mbahet "referendumi" për AAK-në dhe për anëtarësimin e Kosovës në NATO. "Kemi rritje në krejt komunat e Kosovës. Si president i Kosovës ju siguroj se do t'ju nderoj me punë, në Deçan e Dukagjin dhe në gjithë Kosovën. Ju siguroj se do ta nderoj sakrific përliri dhe do ta nderojmë ndihmën e aleatëve tanë. Më 14 është referendum për Aleancën, për Kosovën në NATO", është shprehur Haradinaj.

**Limaj zotohet se do ta nxjerrin ligjin për t'i sankzionuar ata që mohojnë gjenocidin serb në Kosovë**

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se kjo parti, me kauzën e saj për mbrojtjen e vlerave kombëtare, zotohet para qytetarëve të Kosovës se një nga veprimet e para që do t'i ndërmarrë do të jetë nxjerra e Ligjit për dënimin e të gjithë atyre që mohojnë gjenocidin serb të shkaktuar në Kosovë. Në një video mesazh drejtuar qytetarëve, Limaj ka thënë se kjo është gjëja më e vogël që mund të bëjë për viktimat e terrorit dhe gjenocidit serb që ka ushtruar në Kosovë ndaj qytetarëve të pafajshëm, fëmijëve, grave dhe pleqve. "Të gjithë ata që gjenjnjë dhe tentojnë ta devijojnë historinë e dhimbshme, tragjike, por edhe krenare të Kosovës, duhet të sanksionohen me ligj, prandaj një nga iniciativat e para do të jetë nxjerra e ligjit kundër të gjithë atyre që mohojnë gjenocidin dhe masakrat që ka shkaktuar Serbia në Kosovë", ka thënë Limaj.



nga sot. Kudo që po shkojmë nëpër komuna Zoti e ka bo verë, edhe sot është ditë e mrekullueshme në Viti. Unë jam i bindur që të dielën do të festojmë, sepse kudo nëpër komuna ku shkojmë dhe sa herë bisedojmë me grupe të ndryshme të qytetarëve jam i bindur që shumica e qytetarëve në Kosovë e duan demokracinë dhe jo njerëz që duan ta kthejnë vendin prapa në autokraci. Jam i bindur se si në Viti, edhe gjithkund në Kosovë, ka më shumë njerëz të arsyeshëm që kemi punuar tash e 30 vjet për të orientuar këtë vend nga e ka destinimin e fundit - anëtar i BE-së dhe NATO-s, aty ku ka qenë vizioni i presidentit Ibrahim Rugova", ka thënë Hoti.

Më tutje, duke e thumbuar Vetëvendosjen, Hoti ka thënë se zgjedhjet e të dielës janë zgjedhje që e përcaktojnë orientimin e Kosovës. "Zgjedhjet e të dielës

një energji të re dhe vizion të ri, që e ngrit Kosovën krahas vendeve të shekullit 21. Dhe Enver Hoxhaj e ka këtë kalibër dhe cilësinë e udhëheqjes", ka thënë Mushahid Hussain Syed. Ndërsa Enver Hoxhaj e ka falënderuar zyrtarin pakistanez për mbështetjen e tij për zgjedhjet e 14 shkurtit. "Faleminderit për mbështetjen mikut tim të hershëm dhe të Kosovës, Mushahid Hussain Syed, kryetar i Komitetit për Punë të Jashtme të Senatit Pakistanez. Jam krenar përmarrëdhëniet miqësore që kam pasur nderin t'i ndërtoj për Kosovën gjatë karrierës sime në politikë të jashtme", ka thënë Hoxhaj.

Pakistanit është një ndër vendet e para që e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Krahas kësaj mbështetjeje, Hoxhaj ka mbajtur tubime elektorale në Drenas, Skenderaj dhe Fushë-Kosovë.

## Shqipe Mehmeti Selimi: Më 14 shkurt, rinia, gratë dhe vajzat tona do ta vulosin fitoren e LV-së

**PRISHTINË, 10 SHKURT (ER)** - Kandidatja për deputete nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Shqipe Mehmeti-Selimi, ka takuar banorët e disa lagjeve të Prishtinës në kuadër të fushatës elektorale për zgjedhjet e 14 shkurtit. Ajo ka shprehur bindjen se më 14 shkurt do të vuloset fitoria e Lëvizjes Vetëvendosje.

"Prishtina! 'Kalabri', 'Kodra e Diellit' e 'Sofali'. Aktivistët e vullnetarët e Lëvizjes Vetëvendosje janë motori i organizimit të fushatës zgjedhore. Falë tyre tubimet tona janë të shumta, ndërsa neve na mbushin vullnet për të vazhduar para. Rinia, gratë e vajzat tona, këtë të diel do ta vulosin dashurinë për vendin, duke votuar 127-n", ka shkruar Mehmeti-Selimi në llogarinë e vet në "Facebook".

Shqipe Mehmeti-Selimi është bashkëshortja e Rexhep Selimit i cili gjendet në paraburgim në Gjykatën Speciale në Hagë. Ajo në listën e Vetëvendosjes për deputete mban numrin 10, të cilin dikur e mbante bashkëshorti i saj.



#krejtdhedrejt

# Kosova ka dështuar në diplomacinë ekonomike

Ministria e Punëve të Jashtme ka dështuar në diplomacinë ekonomike, përkatësisht në emërimin e atasheve ekonomikë të cilët do të lobonin për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës, për tërheqjen e investitorëve të huaja, si dhe për krijimin e marrëdhënieve ekonomike me shtetet e zhvilluara. Kështu kanë thënë për gazeten "Epoka e re" ekspertë të fushës së ekonomisë, por edhe përfaqësues të bizneseve. Bashkëpunëtori i lartë për hulumtime në Institutin "Riinvest", Pëllumb Çollaku, ka thënë se mungesa e atasheve ekonomikë vjen për shkak të mospërvojës diplomatike të Kosovës. Ndërsa drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, ka thënë për gazeten "Epoka e re" se shteti i Kosovës ka dështuar në diplomacinë ekonomike për shkak të mosmërimit të atasheve ekonomikë në misionet diplomatike

**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHITNE, 10 SHKURT** - Mungesa e atasheve ekonomikë në ambasadat dhe konsullatat e Republikës së Kosovës, në Evropë dhe në botë, është duke u vlerësuar nga ekspertët e ekonomisë dhe përfaqësuesit e bizneseve vendore dhe ndërkombëtare si dështimi i diplomacisë ekonomike të Kosovës.

Ekspertë e ekonomisë, por edhe përfaqësuesit e bizneseve vendore dhe ndërkombëtare, kanë thënë për gazeten "Epoka e re" se atashtë ekonomikë të cilët do të lobonin nëpër botë për përparsitë krahasuese të Kosovës dhe që do të mundësonin më pas tërheqjen e investimeve të huaja, do të duhej të ishin prioritet i Ministrisë së Punëve të Jashtme. Sipas tyre, kjo mungesë është një ndër faktorët kryesorë të mungesës së investimeve të huaja. Lidhur me këtë çështje "Epoka e re" ka provuar të marrë përgjigje edhe nga Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës, e cila aktualisht është nën udhëheqjen e Meliza Haradinaj Stublla, por të njëjtët nuk kanë kthyer përgjigje.

Ndërsa sipas Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ) dhe shërbimin e jashtëm dhe shërbimin diplomatik të Republikës së Kosovës, neni 2, pika 7.2, MPJ-ja, pas marrjes së pëlqimit nga qeveria, ia dërgon emrin e kandidatit për ambasador ose shef misioni në besim, Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Para se të kërkojë pëlqimin nga qeveria, Ministria e Punëve të Jashtme sigurohet se kandidati i plotëson kriteret e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 6 të këtij ligji. Bashkëpunëtori i lartë për hulumtime në Institutin "Riinvest", Pëllumb Çollaku, ka thënë se

mungesa e atasheve ekonomikë vjen si pasojë e mospërvojës diplomatike të Kosovës. Përveç të tjerash, sipas tij, kjo mungesa është debalancën e lartë tregtarë. "Si një vend i ri, mungesa e atasheve ekonomikë është reflektim i mungesës së përvjës së vendit në rrafshin diplomatik. Zakonisht, një nga qëllimet kryesore të diplomacisë është të sigurojë marrëveshje dhe aranzhmane përfituese, njëkohësisht ta mbrojë interesin ekonomik të vendit, e që njihet si diplomaci ekonomike. Nga këtu, mungesa e saj veç po reflektohet në pasoja për vendin që lehtë shihet me thellimin e bilancit negative tregtar me vendet e tjera. Mungesa e dinamikës së lehtësimeve të vazhdueshme për eksportet e Kosovës në tregjet e vendeve ku kemi përfaqësitet tonë diplomatike, dhe ajo e politikave me efekte të limituara për joshjen e investitorëve të jashtëm nga vendet pritëse për në vendin amë (që do ta rrissë edhe fuqinë prodhuase të vendit), kanë kontribuar dukshëm në këtë bilanc negativ", ka thënë Çollaku për gazeten "Epoka e re".

Sipas Çollakut, me fuqizimin e diplomacisë ekonomike Kosova mund të përfitojë në shumë fusha, e sidomos atë të tërheqjes së investimeve të huaja. "Me fuqizimin e diplomacisë ekonomike përmes atasheve ekonomikë mund të bëhem më shumë në rrafshin e marrëdhënive ekonomike në nivelet qeveritare mes vendeve. Sidomos, mund të fillohej të dinamizohet procesi nga nevojat bazike, siç janë ato të mbledhjes, përpunimit dhe ofrimit të informacioneve dhe infrastrukturës përkatëse për palët e interesuara. Këto të fundit janë shumë të rëndësishme për parashikimin e trendëve



ekonomikë mes vendeve dhe të ndihmojnë në konsolidimin e politikave të suksesshme strategjike për joshjen e investimeve të jashtme direkte brenda në vend, si dhe prindërtimin e urave në mes të bizneseve në kuadër të zinxhirëve specifikë të vlerës", ka thënë ai. Meqenëse strategjia e deritashme e Kosovës nuk është treguar efikase atëherë, sipas profesorit të ekonomisë, Pëllumb Çollaku, është më se i nevojshëm emërimi i atasheve ekonomikë. Përveç nevojës së emërimit, sipas tij, është e domosdoshme që atashetë ekonomikë të jenë ekspertë të ekonomisë dhe mos të politizohet me ta. "Meqë në rrafshin e joshjes së investimeve të jashtme direkte dhe jo vetëm, strategjia e deritashme 'one size fits all' është dëshmuar dukshëm e limituar, duket si nevojë rishikimi i emërimit të atasheve ekonomikë, veçse të emëruarit duhet të jenë specialistë të dëshmuar të çështjeve të ekonomisë me ekspertiza përkatëse. Kjo është shumë e nevojshme për funksionim më të mirë dhe për identifikim të suksesshëm të mundësive që burojnë nga konstalacioni i komplikuari i ekonomisë botërore", ka thënë Çollaku, duke rekomanduar kështu edhe mënyrën se si do të duhej të funksionin atashetë ekonomikë. "Për një rezultat më të mirë mendoj që ata duhej të lidhen me ministritë e linjës përkatëse, p. sh., Ministrinë e Tregtisë dhe

Industrisë, Zhvillimit Ekonomik etj. Me inputet dhe informatat e tyre ata do të ndihmonin dukshëm për formulimin e politikës së jashtme, në marrëveshjet ndërkombëtare dhe promovimin e prodhimeve të Kosovës në tregjet e huaja dhe përritjen e prodhuesve vendorë. Kjo do të bëhej e mundshme përmes dinamizmit të takimeve me biznesmenë nga vendi amë dhe pritës, me pjesëmarrje në panairë, konferanca, ekspozita tregtare etj", ka deklaruar ai.

Më tutje, Çollaku ka përmendur një varg përfitimesh që do të mund t'i sillnin Kosovës atashetë ekonomikë. "Në përgjithësi, ata mund të kontribuonin në fusha si: çështjet financiare, bankare, tregtare, projekte të zhvillimit ekonomik, zhvillim komunikimi dhe transport, në projekte dhe çështje mjedisore, shkencore dhe teknologjike", ka thënë ai. Kurse sa i përket rrjetëzimit potencial të atasheve ekonomikë, Çollaku ka përmendur shtetet të cilat potencialisht do të ishin urë lidhëse në mes të investitorëve të huaj dhe Kosovës. "Vendet e dëshmuara me 'know-how' dhe pozicion të rëndësishëm në zinxhirët e vlerës dhe potenciali i investimeve si: Gjermania, Zvicra, Austria, Franca, Italia, Holanda, Izraeli, Japonia, Mbretëria e Bashkuar dhe ShBA-të (e sidomos tri të parat shkaku i mundësisë përrjetësim më të lehtë përmes bashkatdhatarëve tanë në këto vende) duhet të janë gjithmonë

interes primar i Kosovës në mënyrë që t'i sigurojnë qeverisë së Kosovës informacione ekonomike dhe analiza të zhvillimeve ekonomike në vendet pritëse, që më pas do të përkthehet në projekte konkrete inventive në Kosovë", ka thënë Çollaku.

**Ujkani: Diplomacia ekonomike duhet të jetë prioritet**

Drejtori ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë (KIE), Emrush Ujkani, ka thënë përgjithësi, ata mund t'i kontribuonin në fusha si: çështjet financiare, bankare, tregtare, projekte të zhvillimit ekonomik, zhvillim komunikimi dhe transport, në projekte dhe çështje mjedisore, shkencore dhe teknologjike", ka thënë ai. Kurse sa i përket rrjetëzimit potencial të atasheve ekonomikë, Çollaku ka përmendur shtetet të cilat potencialisht do të ishin urë lidhëse në mes të investitorëve të huaj dhe Kosovës. "Vendet e dëshmuara me 'know-how' dhe pozicion të rëndësishëm në zinxhirët e vlerës dhe potenciali i investimeve si: Gjermania, Zvicra, Austria, Franca, Italia, Holanda, Izraeli, Japonia, Mbretëria e Bashkuar dhe ShBA-të (e sidomos tri të parat shkaku i mundësisë përrjetësim më të lehtë përmes bashkatdhatarëve tanë në këto vende) duhet të janë gjithmonë

gjykojen të jenë të mira ose jo, por nëse s'e kemi një diplomaci më të zhvilluar ekonomike, përpjekjet janë të kota. Prandaj, diplomacia ekonomike nga ligjvënësit në Kosovë duhet të jetë prioritet në mënyrë që të na lehtësohen mundësitat e tjerheqjes



së investimeve të huaja. Është momenti i fundit kur duhet të merret vendim për këtë çështje dhe assesi mos të neglizohet", është shprehur Ujkani.

Ndërsa drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, ka thënë për gazeten "Epoka e re" se shteti i Kosovës ka dëshuar në diplomacinë ekonomike për shkak të mosemërimit të atashevë ekonomikë në misionet diplomatike. "Shteti i Kosovës ka dëshuar tash e sa vite përfshin edhe mosemërimin e atashevë ekonomikë nëpër misionet diplomatike të Kosovës, të cilët do të promovonin para investitorëve të vendeve pritëse mundësitet e investimit në Kosovë, por edhe do të ndihmonin në promovimin e produkteve të Kosovës. Kjo ndikon në moshfrytëzimin e një potenciali të madh i cili do të duhej të vihej në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit", është shprehur Zeka.

Në lidhje me këtë çështje, kryetari i Shoqatës së Eksportuesve të Kosovës, Nexhat Hasani, ka thënë për gazeten "Epoka e re" se është për keqardhje sesi Kosova nuk ka emëruar deri më tanë atashevë ekonomikë. Sipas tij, në mungesë së atashevë ekonomikë, por edhe për shkak të pandemisë Covid-19, shumë prodhues të Kosovës i kanë humbur tregjet e tyre. "Është për keqardhje që nuk është bërë asnjë

nga diplomacia e Kosovës për emërimin e atashevë ekonomikë. Prandaj, është momenti i fundit kur duhet të ndodhë kjo. Mungesa e atashevë ekonomikë, të cilët do të ishin ura lidhëse në mes të tregut të Kosovës dhe vendeve me të cilat kemi bashkëpunim ekonomik, është mjaft sfiduese për gjetjen e tregjeve të reja për eksportuesit e Kosovës, pasi me anë të tyre do të eksposozheshin përpërshëtë krahasuese të Kosovës dhe do të ishin dorë e zgjatur e ekonomisë së vendit", ka thënë Hasani, duke shtuar se kjo mungesa ka ndikuar edhe në humbje të tregjeve për eksportuesit e vendit. "Në saje të pandemisë, por edhe të mungesës së atashevë, shumë eksportues kanë humbur tregjet e tyre", ka thënë ai. Sipas tij, atashetë ekonomikë medoemos duhet të emërohen në vendet ku Kosova ka bashkëpunim të mirë diplomatik. "Vendet kryesore, si Italia që ka më së shumti eksportë Kosova, pastaj Zvicra, Gjermania, Austria, pra këto shtete me të cilat Kosova ka raporte të mira edhe diplomatike, por edhe ekonomike dhe me ato shtete që ka importe", ka deklaruar Hasani, duke shtuar se trupat diplomatikë të Kosovës deri më tanë s'kanë bërë kurrfarë pune sa i përket diplomacisë ekonomike. "Trupat diplomatikë që i ka Kosova nëpër botë, pra konsulj, deri më tanë s'kanë bërë kurrfarë pune sa i përket diplomacisë ekonomike", ka deklaruar ai.

Në anën tjetër, njohësi i çështjeve ekonomike, Safet Gérxhaliu, ka thënë se është i domosdoshëm emërimi i atashevë ekonomikë. Sipas tij, diplomacia ekonomike dhe ajo politike kanë dëshuar, sidomos me emërimet në baza politike e jo meritore. "Diplomacia, qoftë politike, ekonomike, kulturore apo ushtarakë, është pasqyrë reale e një shteti dhe në këtë drejtim Kosova ka dëshuar, pasi nuk ishte e orientuar në vlera, por në militantë partiakë për t'i pozicionuar këto vende. Ke sot diplomatët në vendë të ndryshme që s'e njohin gjuhën dhe kulturën e atij vendi dhe si mund të këtë përfitme pozitive nga ta", ka thënë Gérxhaliu.

Ai ka thënë se është për keqardhje se si MPI-ja nuk ka marrë hapa konkretë pasi, sipas tij, rëndësia e atashevë ekonomikë nuk është vetëm e aksit ekonomi, por edhe atij politik dhe psikologjik. "Është për keqardhje heshtja e Ministrisë së Punëve të Jashtme kur dihet se sa nota verbale e qeverive evropiane dhe më gjerë janë dërguar te MPI-ja për pakënaqësinë me diplomacinë politike të Kosovës dhe me një shtet që i ka bërë Kosovës. Rëndësia e një atashevë ekonomik nuk është vetëm aspekti ekonomik, por edhe politik dhe psikologjik. Duhet të dish të mendosh dhe të komunikosh në aspektin gjografik. Jeni duke e parë se vendet e BE-së dhe Ballkanit janë partnerë strategjikë dhe aty duhet të dërgohen njerëz që i meritojnë ato pozita", ka thënë Gérxhaliu.

## INDEP-i: Subjektet politike po injorojnë të drejtat e konsumatorëve

**PRISHTINË, 10 SHKURT (ER) -** Programet e partive politike në prag të zgjedhjeve të 14 shkurtit nuk kanë paraparë mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve në priorititet e tyre. Kjo neglizhencë e partive politike ndaj një grapi shoqëror që praktikisht reflekton të gjithë popullatën është shqetësuese dhe e papranueshme.

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) dhe mbrojtësit e konsumatorëve u kanë bërë thirrje partive politike ta sqarojnë pozicionin e tyre karshi të drejtave të konsumatorëve dhe t'i reflektojnë nevojat e tyre në programet politike për të ardhmen. "Vetëm gjatë vitit 2020 në faqen e mbrojtësve të konsumatorëve kemi marrë mbi 200 ankesa nga qytetarët për shkelje të ndryshme gjatë blerjes së produkteve apo shërbimeve. Në hulumtimet që kemi bërë mbi zbatimin e Ligjin nr. 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit ne kemi gjetur mangësi dhe kemi parë nevoja për avancim të legjisacionit në këtë fushë. Për më tepër, në sektorët si energjia, nafta, shitja me pakicë e produkteve etj.,



kemi parë hapësirë për përmirësimin në proceset e menaxhimit të ankesave, aftësive të rregullatorëve për t'i monitoruar subjektet që ata rregullojnë dhe raportit që ndërtohet me konsumatorët", ka njoftuar INDEP-i, duke kritikuar partitë politike për qasjen ndaj konsumatorëve. "Për fat të keq, në zgjedhjet e sivjetme si konsumator nuk do të kemi rastin t'i krahasojmë programet politike, masat që janë paraparë për konsumatorët, afatet kohore, investimet dhe instrumentet e tjera politike. Kjo na privon që

të bëjmë zgjedhjen bazuar në program dhe të kërkojmë llogari për zbatimin e pretimeve të bëra", ka njoftuar INDEP-i. Instituti INDEP u ka bërë thirrje partive politike që ta rishqyrtojnë qasjen e tanishme dhe të shpalosin ide dhe program konkret për t'i përmirësuar të drejtat e konsumatorëve. "U bëjmë thirrje qytetarëve që në tubimet politike të kërkojnë llogari nga politikanët që kërkojnë vota dhe ta ngrehin kauzën e konsumatorit", ka njoftuar INDEP-i.

## Zyrtarët e organizatave buxhetore trajnohen për zbatimin e procedurave të financave publike

**PRISHTINË, 10 SHKURT (ER) -** Në vazhdën e ngritjes së njohurive të zyrtarëve të organizatave buxhetore për financat publike, Ministria e Financave, me mbështetjen e qeverisë gjermane, ka publikuar të mërkurën në uebfaqe video-trajnimin e radhës në kuadër të "e-mësimit për financat publike".

Nëpërmjet këtij video-materiali zyrtarët do të trajnohen për rëndësinë dhe zbatimin e Udhëzimit Administrativ 05/2019 për procedurat e transferimit dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore. Po ashtu, trajnimi do të ndihmojë për vetëdijesimin e organizatave buxhetore për transparencën e procesit buxhetor, në përputhje

me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitet. Ky projekt do të vazhdojë edhe më tutje duke zhvilluar dhe prezantuar videotrajnimet e radhës, të cilat do të prezantojnë rëndësinë dhe zbatimin e udhëzimeve dhe normave të tjera ligjore për financat publike.



## Mbahet trajnimi me të rinjtë e Komunës së Drenasit

DRENAS, 10 SHKURT (ER) - Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik (DZhE) në Drenas, në bashkëpunim me Agjencinë për Zhvillim Rajonal Qendër (AZhR), kanë mbajtur trajnim për nxënësit, studentët dhe gjithë të interesuarit në kuadër të projektit "Trajnimi profesional dhe angazhimi në punësim" me titull: "Trajinim për orientimin në karrierë/Trajinim për aftësi të buta" të organizuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Në këtë trajnim të gjithë të interesuarit kanë pasur mundësinë të trajnohen në mënyrë profesionale rrëth orientimit në karrierë. Me këtë rast, drejtoresha e DZhE-së, Egzona Jetullahu, ka theksuar se përmes këtyre trajnimeve të rinjtë mund të përfitojnë shumë rrëth orientimit në



karrierë dhe përgatitje për tregun e punës. "I gëzohem faktit që edhe këtë vit të rinjtë e komunës sonë përfituan nga ky aktivitet dhe tashmë janë të

trajnuar dhe kanë fituar një përgatitje shtesë për tregun e punës dhe shpresoj që edhe më tutje do të vazhdojë të rritet bashkëpunimi me

aktorët në fjalë duke krijuar këshku kushte më të mira për të rinjtë tanë", është shprehur Jetullahu. Po ashtu, te gjithë pjesëmarrësit janë certifikuar

për trajnimin e ndjekur, duke përfituar njohuri si t'i ngrehin kapacitetet e tyre në fushën e ndërmarrsisë dhe angazhimit në punësim.

## Gjilani dhe YIHR-KS nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi



GJILANI, 10 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka nënshkruar të mërkurën një memorandum bashkëpunimi me Youth Initiative for Human Rights - Kosovë (YIHR-KS), e cila përfaqësohej nga drejtoresha ekzekutive Marigona Shabiu.


Qëllimi i këtij memorandumi është ta lehtësojë bashkëpunimin në mes të YIHR-KS dhe Komunës së Gjilanit në kuadër të fushëveprimit të organizatës që për qëllim ka t'i fuqizojë të rinjtë të kërkojnë drejtësi dhe të bëhen pjesëmarrës aktivë në sektorin e drejtësisë në

Kosovë si dhe ta rrisë qasjen në drejtësi në nivelin komunal. Në kuadër të këtij memorandumi Komuna e Gjilanit do t'u mundësojë katër studentëve të mbajnë punë praktike tremujore në institucionin e saj në kuadër të projektit "Rritja e qasjes në drejtësi në nivel komunal".

## Komuna e Podujevës shpall konkurs për ndarjen e bursave për nxënës dhe studentë

PODUJEVË, 10 SHKURT (ER) - Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës ka shpallur konkurs për ndarjen e bursave për nxënës dhe studentë të kësaj komune për vitin shkollor/akademik 2020/21. "Dokumentet dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë në objektin e komunës - rruga 'Nuhi Gashi', në afat prej 15-ditësh nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve të objektit

të komunës, në mediat e shkruara dhe në uebfaqen e komunës", ka njoftuar Komuna e Podujevës. Kjo komuna ka bërë me dije se shuma e bursës do të caktohet varësish nga buxheti që do të ketë kjo komunë. Po ashtu, Komuna e Podujevës ka shpallur thirrjen publike për mbështetje financiare të organizatave joqeveritare, për zbatimin e aktivitatave kulturore, rimore, sportive në këtë komunë.



## Komuna e Junikut pajiset me traktor për pastrimin e borës dhe fshirjen e rrugëve

JUNIK, 10 SHKURT (ER) - Komuna e Junikut, për shkak të performancës së mirë, në kuadër të projektit "Shërbime të qëndrueshme komunale", GIZ-i në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, në raundin e parë të grantit të performancës (mjedisi i pastër) është shpërblyer, duke qenë përfituese e fondit në vlerë prej 45 mijë e 848 eurosh.

Kryetari i Junikut, Agron Kuçi,

ka mirëpritur përfaqësueset nga GIZ-i, ku edhe është bërë pranimdorëzimi i traktorit për pastrimin e dëborës dhe fshirjes së rrugëve. Me këtë rast, Kuçi ka falenderuar GIZ-in për përkrahjen e vazhdueshme që është duke i ofruar Komunës së Junikut. Komuna e Junikut, sipas vlerësimit nga GIZ-i, që nga viti 2018 ka zero deponi ilegale si rezultat i angazhimit për "Junikun e pastër dhe ekologjik".



# Kosova, kubëz e munguar në mozaikun politik të ndryshuar të Ballkanit, drejt të së majtës



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**Gjeopolitika e korruptuar në Ballkan:** Shtetet e Ballkanit deri vonë janë konsideruar si zona gri e Evropës, prandaj i janë dhe po u nënshtron eksperimenteve të ndryshme. Vendimmarrja evropiane ka efekte zero pa koordinim dhe përkrahje amerikane. Evropa merr vendime, por ShBA-ja e bën noterizimin e këtyre vendimeve. Edhe amerikanët, ashtu edhe evropianët, janë pragmatikë për trajtimin e problemeve të Ballkanit, duke i anashkaluar parimet e korrektesisë dhe të drejtat, nëse janë në kundërshtim me interesat e vendimmarrësve të vërtetë. Të dyja palët, për realizimin e qëllimeve të tyre, janë në gjendje të bashkëpunojnë me "djallin dhe të birin" për t'i shtyrë para projektet e tyre. Deklarohen kundër krimit të organizuar, ndërsa mbështesin qeveritë puro kriminale për aq sa kanë nevojë e pastaj i hedhin, ose në burgje, ose në shportën e hedhurinave! Deklarohen kundër korruzionit në kohën kur të gjitha privatizimet dhe tenderët qindra miliona eurosh i marrin përfaqësuesit e shteteve nga vijnë, prapa të cilëve qëndrojnë politikanë të fuqishëm ndërkombëtarë. Deklarohen kundër krimit të organizuar, përdrejtësi dhe kundër nepotizmit kur vetë ata janë, në hije, spiritus movens i këtyre dukurive. Deklarohen kundër pastrimit të parave kur këto vende i përdorin përdorim të parave dhe i shndërrojnë në deponi të mjeteve radioaktive dhe materialeve me rrezikshëm të lartë. Deklarohen kundër ekstremizmit politik dhe fetar kur këto dukuri fillimisht i përkrahin e pastaj i përdorin përdiferecime dhe gjeografi politike. Deklarohen përdorim të respektit të vullnetit të popullit, ndërsa nuk lejojnë të bëhet rendi i ditës përbledhje të institucioneve, që nga niveli i ulët e deri tek ai i larti. Vëtë marrin vendime përofrim të qeverive të këtyre vendeve dhe vetë marrin vendime kur duhet të rrëzohen këto qeveri. Të shkojmë me radhë:

**1. Serbia:** Në momentin kur më nuk pati nevojë për Sllobodan Milosheviqin, bashkësia ndërkombëtare nxiti trazira dhe demonstrata në Serbi, duke e dërguar "kasapin e Ballkanit" në Hagë. E shfrytëzuan luftën e UÇPMB-së jo për të drejtat e shqiptarëve, por për ta lehtësuar rrëzimin e Milosheviqit. Pas kësaj e hoqën rripin e sigurisë prej 5 km

midis Kosovës dhe Serbisë duke ua lënë duart e lira xhandarëve dhe paramilitarëve të Serbisë të arrestojnë, vrasin dhe shpërçgulin me dhunë shqiptarë të Luginës. Ia hoqën Serbisë embargon e furnizimit me armë duke kushtëzuar disa shtete që prodhojnë armë që një pjesë të armatimit ta blejnë nga Serbia. Në Kosovë ia lanë të gjitha mundësitë për të ndërhyrë në çështjet e brendshme që prodhoi pasiguri të vazhdueshme. Ia liberalizuan vizat, pa e kushtëzuar me asgjë. Ia rehabilituan të kaluarën dhe të tashmen kriminale. Ndonëse e kanë të qartë se Aleksandër Vuçiç ishte dhe është kriminel lufte, me përkrahjen që ia dhanë dhe po ia jepin, ia forcuan autokracinë absolute sikur që i mbyllën sytë për zgjedhjet e manipuluara nga krimineli i luftës, Aleksandër Vuçiç. E lejuan që Serbia, përvëç ndërhyrjes flagrante në Kosovë, të ndërhynë edhe në Mal të Zi dhe Maqedoni të Veriut. Një kriminel të luftës e shndërruan në lojtarin numër 1 sikur dikur kur Slloboadan Milosheviqin e konsideron si paqeberësin kryesor në Ballkan, "peace maker"!

**2. Maqedonia e Veriut:** Dikur përkrahin Georgievskin, më vonë Nikolla Gruevskin kurse tanë, për nevoja politike dhe strategjike, po e përkrahin Zaevin. Për ta luftuar Gruevskin dhe për ta forcuar Zaevin, e pajisën me dosje sekrete dhe përgjime që iu kishin bërë, kryesisht shqiptarëve e që pastaj, varësisht nga nevoja politike, eksplodonin si "bomba të Zaevit". Këto bomba për politikanët maqedonas e kishin efektin e pordhës, kurse për politikanët shqiptarë vërtet ishin bomba me të cilat e siguruan heshtjen dhe dëgjueshmërinë e tyre, kryesisht në dëm të shqiptarëve. Këto "bomba të Zaevit" nuk e zbardhën asnjë krim që u bë ndaj shqiptarëve dhe asnjë proces të montuar përvëçse e blenë dëgjueshmërinë absolute të shqiptarëve që, për t'i ikur burgut, bën c'kërkohet nga ta. Këto "bomba" ishin mjet shantazhi që do të dënoheshin në çdo shtet dhe me këto "bomba" shqiptarët (politikanët, kryesisht) shantazhohen edhe sot. Tash Zaevi është i paprekshëm në Maqedoninë e Veriut dhe do të jetë i tillë për aq kohë sa kanë nevojë për të, ata që marrin vendime. Maqedonisë së Veriut iu liberalizuan vizat, jo se i përbushën kriteret e parapara, por se e kaluan provimin e dëgjueshmërisë dhe përshtatshmërisë politike.

**3. Mali i Zi:** Fillimi i përkrahën Millo Gjukanovicin i cili e jetësoi pavarësinë e vërtetë të Malit të Zi duke e nxjerrë nga ndikimi i Serbisë dhe Rusisë. Millo Gjukanoviqi e përligji identitetin malazias dhe e forcoi Malin e Zi

deri në kohën kur bashkësia ndërkombëtare e vlerësoi se nuk ka më nevojë për të dhe shërbimet e tij. Tash po e akuzojnë për korrupsion, nepotizëm dhe krim të organizuar në ndërkohë që, kur kishin nevojë për të, këto dukuri as që i vërenin. E lejuan që të rikthehet ndikimi i Serbisë dhe i Rusisë duke e bërë Kishën Ortodokse serbe partner të shtetit. Në zgjedhjet e fundit e përkrahënyrat "reformiste" duke ia hapur varrin politik Millo Gjukanovicit, identitetit malazias sikur edhe vetë shtetësisë së Malit të Zi. Një Dritan Abazoviq po e përdorin si shpatë për heqje të kokave të kundërshtarëve politikë. Si politikan që deklarohet se flet edhe gjuhën shqipe, këtë shpatë e përdori pikërisht për t'i prerë kokat e politikanëve shqiptarë në Mal të Zi. Bashkësia ndërkombëtare ia hoqi vizat Malit të Zi ndonëse ishte larg përbushjes së kritereve të kërkua. Edhe atëherë Millo Gjukanovic ishte në pushtet, por se në atë kohë bashkësia ndërkombëtare kishte shumë nevojë për shërbimet e Millos, kurse tanë ka nevojë për shërbimet e Krivokapiqit, Abazoviqit që po e përdorin si marionetë sikur edhe për ndikimin e Serbisë në Mal të Zi. Shqiptarët në Mal të Zi nuk janë asgjekundi. Po të mos ishte Gjyste Vulaj, askush nuk do të dinte se në Mal të Zi ka shqiptarë!

**4. Bosna dhe Hercegovina:** Bashkësia ndërkombëtare e ndau dhe e bëri shtet jofunksional Bosnjën dhe Hercegovinën. E lejoi që të bëhet Republika Serpska në Bosnje sikur një të korruptuar dhe bartës të të gjitha krimeve në Bosnje, Miroslav Dodikun, e bëri mbret. I ka bërë tri entitete territoriale, etnikisht të pastra që, nëse paraqitet nevoja, lehtësisht i bashkohen Serbisë dhe Kroacisë, kurse pjesën e mbetur e ndajnë si të duan. Tash, pasi që u kanë dalë probleme të tjera, kanë vendosur që ta dobësojnë pakëz Dodikun jo për ta larguar nga pushteti, por për ta bërë pak më të dëgjueshmë. Edhe Bosnja dhe Hercegovina, ndonëse ka qenë dhe është shtet më jofunksional se Kosova, pameritueshmë përfitoi nga liberalizimi i vizave dhe në proceset integruuese.

**5. Shqipëria:** Bashkësia ndërkombëtare Shqipërinë e konsideron si shtet i korruptuar, vend të kanabisit, shpëljarës së parave, prostitucionit dhe krimit të organizuar pa e pranuar se pikërisht bashkësia ndërkombëtare ka luajtur rolin vendimtar për të gjitha këto dukuri. Edhe Shqipëria përfitoi nga liberalizimi i vizave, ndonëse heqen e liberalizimit të vizave ia mbajnë mbi kokë, për të siguruar dëgjueshmëri politike. Bashkësia ndërkombëtare Shqipërinë e përdorë më shumë për të bërë presion mbi politikanët kosovarë



se që duan që Shqipëria të jetë pjesë e zgjdhjes së problemeve. Në Shqipëri në pushtet është Edi Rama dhe pas zgjedhjeve të ardhshme përsëri do të jetë Edi Rama. Për aq kohë sa do të ketë nevojë bashkësia ndërkombëtare për të.

**6. Kosova:** Nuk ka shtet që është dhunuar më shumë se Kosova nga bashkësia ndërkombëtare. Eksperimentet më të fëlliçura janë bërë në Kosovë, kinse jemi shtet, kurse vendimet i marrin ndërkombëtarët. Nuk ka qeveri që është formuar pas luftës ku nuk kanë ndikuar ndërkombëtarët. Nuk ka qeveri që është rrëzuar në Kosovë e që nuk ishin si mami ndërkombëtarët! Deri vonë pushtetin absolut në marrje të vendimeve e kishin ndërkombëtarët, kurse përgjegjësia iu adresohej vendorëve. Sikur edhe në shtetet e tjera të Ballkanit, ndërkombëtarët ndikuan në mënyrën e qeverisjes dhe garniturën qeverisës përfaktin se i njihnin mirë ata që "qeverisën", por se tërë kohën për aq kohë sa kishin nevojë bashkëpunuani me ta. Ndërkombëtarët e lejuan dhe po e lejojnë Serbinë të bëjë ç'të dojë në Kosovë.

E imponuan decentralizimin në baza etnike, demarkacionin, Asociacioni e Serbisë në Kosovë dhe marrëveshje të tjera për të cilat as që është pyetur Kosova. Vetëm Kosovë nuk ia lejuan lëvizjen e lirë në Kosovë duke e futur në rrugë qorre. Vazhdimisht kërkonin kriteret e reja duke e fshehur faktin se kriteri kryesor është marrëveshja me Serbinë. E ndan Mitrovicën në dy qytete, 15 vjet pas përfundimit të luftës. Krimet e luftës po i trajtonë duke arrestuar dhe dënuar shqiptarë në 90 për qind të rasteve. Për të prodhuar sa më shumë pasojë politike, arrestuan ish-kërët e UÇK-së dhe udhëheqësit më të lartë të institucioneve të vendit: Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin, Rexhep Selimin, Salih Mustafëni, Nasim Haradinajn dhe Hysni Gucatin, të cilëve, edhe si të arrestuar, në mënyrë flagrante po ua shkelin të drejtat e njeriut. Me arrestimin e tyre duan ta ndërtojnë një gjeografi dhe arkitekturë të re politike që do ta përdorin përgjime dhe nevoja politike. Atë që deri dje e ndoqën, e dhunuan, e burgosën si policia e UNMIK-ut, ajo e EULES-It, një pjesë e Policisë së Kosovës, politika vendore dhe sidomos ajo ndërkombëtare, Albin Kurtin tani duan ta promovojnë duke e rikthyer nëpër dyer të mëdha dhe të arta, për aq kohë sa kanë nevojë për të. Me arrestimin politik të të burgosurve që janë grabitur dërguar në Hagë, po u hapin rrugë të gjithë atyre që kanë vlerësuar se kanë nevojë për ta në arritjen e marrëveshjes me Serbinë. Nëse iu

del ashtu! Nëse jo, e provojnë me një garniturë tjetër nga menyja e sajtar nga ndërkombëtarët. Kosovës nuk po i hapin rrugë sikur shteteve të tjera që ua kanë njohur lëvizjen e lirë. Kosovën po e fusin në krizë për ta lehtësuar arritjen e marrëveshjes me Serbinë, si kusht për përkrahje. Do të bindeni, shumë shpejt!

**Ballkani i rreshtuar në të majtë:** Është një tendencë që shtetet e Ballkanit të radhitën në të majtën, në emër të një socialdemokracie të rrejshme. Në Serbi, në pushtet është regimi çetnik i Vuçiqit i cili përdorë politika sociale (të majta) për ta mbajtur pushtetin. Në Mal të Zi majtistët erdhën në pushtet, por që përdorin politika të djaththa dhe kishtare të mbësin në pushtet. Në Bosnje dhe Hercegovinë nuk dihet çka është e majtë apo e djathë, por se oligarkët e mbajnë pushtetin. Në Shqipëri e majta është në pushtet, thirret në drejtësi sociale, kurse ka më shumë milionerë se në shumë vende kapitaliste. Në Maqedoninë e Veriut, Zaevi është i majtë, por se xhironlogarinë e ka puro kapitaliste (djathitë) sikur edhe pjesa më e madhe e atyre me të cilët bashkëqeveriste. Në Kosovë IV-ja që llogaritet favorite kryesore përfitore në zgjedhjet e 14 shkurtit, llogaritej si e majtë, kurse lista e propozuar për deputetë përmban milionerë, djathitë, anarkistë, "nacionalistë", hajdutë të fondeve, mashtrees, ishtitistë,blerës të shërbimeve seksuale dhe, maja e të gjithë këtyre është "Hasan Prishtina" i Mitrovicës. Nëse deri dje IV-ja ishte e majtë, e themi të vërtetën. Nëse deri dje flisnim për idealizmin e këtij mish-leshi politik, kishte një kuptim. Sot nuk ka asnje kuptim. Nëse deri dje IV-në e konsideronim si strehë për idealistë të bashkimit kombëtar, sot lirisht mund ta konsiderojmë si strehë të horrave që kanë manipuluar me këtë ideal. Mirëpo, kjo IV sot iu duhet shumë ndërkombëtarëve, prandaj po e përkrahin si mekanizëm për ta luftuar korruzionin, nga të pakorruptuarit. Unë votën time nuk ia jap askujt sepse nuk e meritojnë. Uroj që ta kem shumë gabim dhe, nëse vërtet do ta kem gabim, do t'u kërkoj falje deri te Zoti. Mirëpo, i njoh që nga koha kur ishin embrion politikë, shumë mund kam bërë për ta! Nuk është kjo IV-ja që e kam përkrahur kur të gjithë e kanë sharë dhe sulmuar e që tani janë në listën për deputetë të trajtuar si shumë të nderuar. Kushdo që më tregon se Albini e ka përmendur Bacën Adem Demaci do ta qeras një kafe, përfillim. Nëse nuk e përmend fare, do t'i qeras dy kafe. Definitivisht nuk është kjo IV-ja që e ka përkrahur Baca Adem Demaci. Aty janë pakicë që e njohin Bacën, kurse një numër jo i vogël janë urryes të Bacës e që janë shumë afër Albinit.



# JOE BIDEN LETER HISTORIKE PËR KOSOVËN DERGUAR SERBISË



Ismet SYLEJMANI

Presidenti i SHBA-së Joe Biden, pas inaugurimit historik të Tij President i 46-të, i ka nisur një letër

historike Serbisë dhe presidentit të sajë Aleksandër Vučiq! Shefi i Shtëpisë së Bardhë, miku i madh i Kosovës dhe i popullit shqiptar, i ka kërkuar Serbisë dhe presidentit të sajë antishqiptar Vučiq, ta pranojë dhe ta njohë Republikën e Kosovës, shtet tē pavarur dhe sovran!

Kjo letër për Serbinë dhe për kreun e sajë Vučiq, dërguar nga ana e Presidentit të

SHBA-së Biden, është ngjarje e madhe për Kosovën dhe për popullin shqiptarë e për historinë e lavdishme të truallit tonë! Ky dokument nga Amerika, do të mbetet një ngjarje e madhe e shkruar për historinë e re të Kosovës, dhe do të shënohet me shkronja të arta në analet i historisë botërore! Lufta heroike dhe titanike e popullit shqiptar, gjaku i derdhur për liri i dëshmorëve

dhe heronjëve të kombit tonë, veprimtarë e aktivistë të çështjes kombëtare, ushtarë dhe komandant të UÇK-së, dhuna dhe terrori masiv i Serbisë pushtuese mbi shqiptarët, është përfundimi logjik dhe madhorë që përmblidhet në këtë dokument historik, që mban vulën e Shtëpisë së Bardhë dhe të Presidentit të SHBA-së Joe Biden!

Njohja reciproke në mes të

Kosovës dhe Serbisë do të ndodhë, sepse ky është rekonditimi amerikan që mban vulën e porosisë së madhe të Presidentit të SHBA-së Joe Biden!

Neve shqiptarëve nuk na mbetet asgjë tjetër, pos ta përrëndesim qëndrimin historik në letrën e Presidentit të SHBA-së drejtuar homologut të tij serb Vučiq!

Prishtinë, 10 Shkurt 2021!



# Rugova: Kualifikimi në fazën tjetër është synim i Kosovës

“Atmosfera në ekipin e Kosovës është shumë e mirë. Basketbollistët janë të motivuar dhe sigurisht se do ta japin maksimumin në dy takimet që do t'i kemi gjatë muajit shkurt. Unë besoj fuqishëm në basketbollistët e Kosovës se do t'u qasen ndeshjeve me seriozitetin më të madh e të kualifikohemi në rrithin e ardhshëm, që do të ishte historike për basketbolin e Kosovës”, ka thënë Rugova

**PRISHTINË, 10 SHKURT** - Basketbollistët e Kosovës të martën mbrëma kanë filluar përgatitjet për ndeshjet shumë të rëndësishme që do t'i zhvillojnë këtë muaj. Atmosfera në ekipin e Kosovës është shumë e mirë dhe basketbollistët janë të motivuar për ta dhënë maksimumin dhe për të synuar kualifikim në rrithin e ardhshëm. Drejtori i Përfaqësuesve të

Kosovës, Granit Rugova, ka folur për rrjedhën e përgatitjeve. "Atmosfera në ekipin e Kosovës është shumë e mirë. Basketbollistët janë të motivuar dhe sigurisht se do ta jepin maksimumin në dy takimet që do t'i kemi gjatë muajit shkurt. Unë besoj fuqishëm në basketbollistët e Kosovës se do t'u qasen ndeshjeve me seriozitetin më të madh e të kualifikohemi në rrethin e



ardhshëm, që do të ishte historike për basketbollin e Kosovës”, ka thënë Rugova përfaqen zyrtare të FBK-së. “Angazhimi nuk ka munguar asnjëherë dhe sigurisht se nuk do të mungojë as këtë herë. Ndeshja e parë do të jetë ndaj Luksemburgut, e që besoi në

fitore, ndërsa më pas do të kemi  
sfidën vendimtare me  
Sllovakinë. Kësaj radhe do të  
jemi mangët pa publikun, që  
gjithmonë ka dhënë mbështetje,  
por besoj se të gjithë do të  
përkrasin Kosovën për t'u  
kualifikuar në rrethin e  
ardhshëm". ka deklaruar Rugova

Kosova A më 18 shkurt do të ballafaqohet me Luksemburgun, kurse më 20 shkurt me Sllovaninë. Përballjet zhvillohen nga ora 19:00. Të dyja ndeshjet do të zhvillohen në Prishtinë ashtu siç të gjitha takimet e Grupit B parakualifikues për Botërorin 2023. Në këtë grup Islanda është lidere me tri fitore dhe një humbje, nga dy fitore kanë Kosova dhe Sllovakia, kurse Luksemburgu ndodhet në vendin e fundit me një fitore dhe tri humbje. Nëse "dardanët" shënojnë dy fitore në dy takimet e zhvilluara, atëherë do të kualifikohen në rrethin e ardhshëm. Të gjitha ndeshjet e Dritares së Tretë të Grupit B do të zhvillohen në Prishtinë. Ky ishte vendimi i mëhershëm nga Bordi i FIBA Evropës, duke i besuar edhe një ngjarje të rëndësishme Federatës së Basketbollit të Kosovës.

# Ceremonia e 'Laureatëve 2020' mbahet më 22 shkurt

**PRISHTINË, 10 SHKURT -** Komiteti Olimpik i Kosovës do ta organizojë edicionin e pestë të zgjedhjes së "Laureatëve" për vitin paraprak. Për shkak të masave të marra nga Qeveria e Republikës së Kosovës për mbrojtje nga pandemia Covid-19, ceremonia do të mbahet pa praninë e mysafirëve dhe vetëm me praninë e laureatëve. Ceremonia organizohet më 22 shkurt në "Hotel Swiss Diamond" në Prishtinë dhe do të transmetohet drejtpërdrejt në RTK. Juria në përbërje anëtarë të Bordit Ekzekutiv të KOK-ut, ish-sportistë dhe gazetarë sportivë, do



t'i zgjedhin çmimet për laureatët e vitit 2020, sipas kategorive: Sportistja dhe Sportisti i Vtitit, Trajneri i Vtitit, Kombëtarja e Vtitit (meshkujt dhe femrat), Çmimi Special dhe Shpresa e Vtitit (meshkujt dhe femrat).

# Istogu eliminoi Gjilanin nga Kupa, kualifikohen Feronikeli, Trepça '89 dhe 'A&N'

Istog, 10 shkurt - KF Istogu e ka eliminuar skuadrën e Gjilanit nga gara e Kupës në futboll, pasi e mposhtë në kuadër të 1/8 së finales me rezultat 2-0. Në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Demush Mavraj", Istog u tregua skuadër me e saktë duke shënuar dy gola ndaj skuadrës që drejtohen nga Bylbyl Sokoli, kurse shënues për "Troftat" ishin Yoan Olivier dhe Erjon Qeta. Kualifikimin e ka siguruan edhe Trepça '89 që arritur fitore bindëse ndaj Ferizaj (4-0), dersa dy gola përmirrovicasit i shënoi Muja dhe me një gol kontribuuani Rrahmani dhe Memaj. Eponikeli arriti fitore të



vështirë, por të rëndësishëm ndaj Arbërisë (0-1), pasi golin e fitores e shënoi Miliçkoviç në minutën e parafundit të ndeshjes. Ndërsa në çerekfinale u kualifikua edhe skuadra e "A&N", e cila e mposhti Flamurtarin e Prishtinës (1-0).

# Bashkimi dhe Prishtina përballen në Superligë

**PRISHTINË, 10 SHKURT** - KB Bashkimi dhe KB Prishtina do të përballen sërisht, por kësaj radhe në kuadër të EBC Superligën e Femrave. Këto dy skuadra u sfiduan edhe javën e kaluar në finale të Kupës së Kosovës, ku fitore shënoi skuadra prishtinase dhe fitoi Kupën. Por, në EBC Superligën e Femrave vashat prizrenase kanë 11 fitore dhe vetëm një humbje, kurse vashat prishtinase tetë fitore dhe katër humbie. Takimi pritet të jetë

interesant, ashtu siç ka qenë në vitet e fundit kur janë përballur këto dy skuadra. Kujtjmë se gjatë këtij edicioni këto dy skuadra shkuan në katër vazhdime, një rekord për basketbollin e femrave në Kosovë.

Vëllaznimi - Penza, po ashtu, është një sfidë interesante me të dyja skuadrat që synojnë të renditen sa më lart. Vashat nga Gjakova kanë nëntë fitore dhe tri humbe, kurse ato nga Penza gjashtë fitore dhe gjashtë Kosovë.

humbje. Dueli i fundit do të jetë në mes të Kastriotit dhe Trepçës, ku të dyja skuadrat kanë nga një fitore dhe 11 humbie.

**SUPERLIGA - Java 13**

**Të enjten takohen:**  
**18:00 Vëllaznimi - Penza**  
**19:00 Bashkimi - Prishtina**

**Të premten takohen:  
13:00 Kastrioti - Trepça**



## KOK-u pranon ftesën zyrtare për pjesëmarrje në LOD ‘Pekin 2022’

**PRISHTINË, 10 SHKURT -** Komiteti Olimpik i Kosovës ka pranuar ftesën zyrtare nga Komiteti Olimpik Ndërkontrollor për pjesëmarrje në Lojërat e 24-ta Olimpike Dimërore, të cilat prej 4-20 shkurt 2022 mbahen në Pekin të Kinës. Ftesa e dërguar në mënyrë

elektronike dhe me postë, e nënshkruar nga presidenti i KON-it, Thomas Bach, është tradicionale dhe akt simbolik që bëhet para Lojërat Olimpike Verore dhe Dimërore. Presidenti i KOK-ut, Besim Hasani, me kënaqësi ka pranuar ftesën, derisa

shpreson se LOD “Pekin 2022” do të zhvillohen në një ambient të sigurt dhe pa pasur frikën e pandemisë Covid-19. Presidenti Hasani theksoi se Ekipi Olimpik i Kosovës do të përfaqësoset në Pekin me një ekip më të gjerë sesa në PyeongChang 2018, ku bëri debutimin me

skitarin Albin Tahiri. KOK-u momentalisht ka një normë olimpike me skitarin Arbi Pupovci, ndërsa normën po e kërkojnë edhe skitarët e tjera: Albin Tahiri, Fiona Blaka Rusta e Kiana Kryeziu. Tahiri, Pupovci e Blaka Rusta janë bursistë olimpikë të KOK-ut.



## Listë e gjerë e Kosovës për ndeshjet kundër Luksemburgut dhe Sllovakisë

**PRISHTINË, 10 SHKURT -** Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll gjatë muajit shkurt do t'i zhvillojë dy ndeshje në kualet e parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023. Dritarja e Tretë e kualifikimeve do të zhvillohet në Prishtinë, ku të gjitha ndeshjet e Grupit B do të zhvillohen në kryeqytetin e Kosovës. Kosova A më 18 shkurt do të ballafaqohet me Luksemburgun, kurse më 20 shkurt me Sllovakinë. Përballjet zhvillohen nga ora 19:00.

Përzgjedhësi Christos Marmarinos së bashku me ndihmësit e tij kanë publikuar listën e gjerë me 16 basketbollistë për këto sfida. Basketbollistët e Kosovës të martën mbrëma kanë zhvilluar stërvitjen e parë, kurse stërvitjen e dytë e zhvilluan të mërkurën nga ora 19:00.

**Lista e gjerë e Kosovës:** Divine Myles, Musab Malaj, Valon Bunjaku, Mikaili Tmusiq, Dardan Berisha, Erjon Kastrati, Denis Zenelaj, Arian Qallaku, Meriton Ismaili, Drilon Hajrizi,



Samir Zekiqi, Alban Veseli, Dion Sheqiri, Fisnik Rugova, Gëzim Morina dhe Urim Zenelaj. Përdallim nga ndeshjet e nëntorit, rikthehen Dardan Berisha, Gëzim Morina dhe Samir Zekiqi, kurse basketbollisti i natyrizuar për takimet e shkurtit do të jetë Divine Myles. Për herë të parë te Kosova A janë ftuar Denis Zenelaj dhe Dion Sheqiri. Denisi luan në Gjermani për skuadrën Eisbaren Bremerhaven, ku paraqitet për

juniorët e kësaj skuadre dhe ekipin e parë, kurse Dioni aktivizohet në Itali, te skuadra Allianz Pallacanestro Trieste. Në këtë grup Islanda është lidere me tri fitore dhe një humbje, nga dy fitore kanë Kosova dhe Sllovakia, kurse Luksemburgu ndodhet në vendin e fundit me një fitore dhe tri humbje. Nëse “dardanët” shënojnë dy fitore në dy takimet e zhvilluara, atëherë do të kualifikohen në rrëthin e ardhshëm.

## ‘France Football’ publikon 10 talentët e shkuar dëm, kryeson Cassano

**PARIS, 10 SHKURT -** A mund ta quajmë talent të shkuar dëm një lojtar që ka shënuar rrëth 150 gola në karrierën e tij, fitoi një La Liga, një Serie A dhe dy Superkupa të Italisë? Po nëse emri është Antonio Cassano, i cili mund t'i kishte dhënë shumë më tepër futbollit botëror. Kjo është të paktën ajo që mendon “France Football”, revista sportive franceze që shpiku “Topin e Artë” dhe akoma e jep atë qëdo vit. Ajo ka përpiluar renditjen e dhjetë talenteve më të shkuar dëm në historinë e futbollit. Sipas revistës franceze, këta lojtari mund të kishin dhënë shumë më tepër por, përkundrazi, kanë pasur një karriërë të përzier. Antonio Cassano është në vendin e parë. “France Football” i kujton ish-talentit barez shansin e dështuar te Real Madridi, grindjet me Capellon etj. Përmendet, gjithashtu, një



pasazh nga autobiografia e Tottit, e cila e përcaktion Cassanon si lojtarin më të fortë me të cilin ka luajtur ndonjëherë. Në vendin e dytë të kësaj renditjeje speciale është një tjetër njohje e vjetër e Serisë A, Paul Gascoigne. Në vendin e tretë, Stan Bowles, rekordmen i paraqitjeve me QPR në vitet '70. Në këtë klasifikim ka edhe ish-lojtarë të tjera të Serisë A, të tillë si Andry van der Meyde dhe Adriano Leite Ribeiro.

### Lista e 10 talentëve më të mirë, të shkuar dëm, sipas “France Football”

1. Antonio Cassano
2. Paul Gascoigne
3. Stan Bowles
4. Antonio Valentín Angelillo
5. Dimitar Berbatov
6. Rashidi Yekini
7. Mario Basler
8. Nicolas Anelka
9. Andy Van der Meyde
10. Adriano

### SHKURT

#### Joe Biden do t'i rihapë dyert e Shtëpisë së Bardhë për kampionët e NBA-s

Pas disa vitesh “përplasjesh” mes skuadrave të NBA-së dhe ish-presidentit Donald Trump, duket se me ardhjen e Joe Bidenit në postin e presidentit të Amerikës marrëdhëniet mes palëve do të stabilizohen. Dhe sinjal i parë i këtij normalizimi do të jetë vizita që skuadra kampione e NBA-së, LA Lakers, do të kryejë në Shtëpinë e Bardhë. Sipas mediave amerikane, presidenti Joe Biden do të formalizojë së shpejtë ftesën për skuadrën kampione nga Los Anxhelosi, duke rikthyer traditën e ndërpërre, kur ekipet e NBA-së refuzonin ta takonin Donald Trumpin. Pritet që brenda shkurtit Lakersat të ftohen ta festojnë titullin në Shtëpinë e Bardhë, natyrisht duke respektuar masat kundër Covidit. “Do të ishte një kënaqësi përmua dhe skuadrën e lakersave të shkojë në Shtëpinë e Bardhë”, ka thënë LeBron James, duke konfirmuar se këtë herë nuk do ta refuzojë ftesën.

#### Silva ‘godet’ PSG-në: Meritoja më shumë respekt

Thiago Silva në verë la Paris Saint Germainin pas tetë sezonesh përuar te Chelsea në Premierë Ligë. Aktualisht mbrojtësi brazilian, tashmë 36-vjeçar, është i lumtur te blutë e Londrës, por në një intervistë Thiago është rikthyer të flasë për PSG-në dhe rinovimin e mundshëm të kontratës me kampionët e Francës, duke zbuluar se drejtuesit e PSG-së e trajtuan shumë keq si atë ashtu edhe Edinson Cavanin duke mos u bërë asnjë ofertë përzgjatjen e bashkëpunimit. “PSG nuk më ofroi asgjë. Nuk më tha as: Thiago, a pranon të luash me ne përm 1 euro? Absolutisht asgjë. Unë meritoja më shumë respekt. E njëjtë gjë ndodhi edhe me Edinson Cavanin”, ka deklaruar ish-kapiteni i PSG-së.

#### Benzema: Jemi rikthyer në garë për titull

Sulmuesi Karim Benzema insiston se Real Madridi është rikthyer në garën për titull. Reali, pavarësisht prej mungesave të shumta, mposhti Getafën (2-0), kurse Atletico Madrid barazoi me Celtan. “Mendoj se jemi rikthyer. Është gjithmonë vështirë kundër Getafes. Ne do të vazhdojmë kështu. Ka shumë kohë deri në fund të sezonit. Çdo ndeshje është finale dhe ne do të mundohemi i fitojmë të gjitha. Kemi besim. Ka shumë zhurmë rrëth Madridit sepse është klub më i mirë në botë”, ka thënë Benzema.

#### Në garë për Alaban është edhe Chelsea

David Alaba mbetet një nga emrat më të nxehët në mercaton e transferimeve. Largimi i tij me parametra zero në fund të sezonit bëri që shumë klube t'i viheshin pas përt a joshur. Në Spanjë nuk kanë asnjë dyshim që Alaba sezoni e ardhshëm do të luajë në Madrid, madje flasin edhe përm një parakontratë me Realin. I bindur në këtë duket edhe drejtori i përgjithshëm i Bayern München, Karl Hans Rummenigge por, prej pavarësisht krye detajeve në Angli, kanë një tjetër version. Sipas “Daily Telegraph”, në garë përt i siguruar shërbimet e mbrojtësit është futur edhe Chelsea. Londinezët janë të gatshëm të negociojnë me përfaqësuesit e lojtarit edhe pse kërkesat e tij ekonomike janë shumë të larta, kërkon një pagë sezonale prej më shumë se 20 milionë euro në sezon. Blutë ishin klub më aktiv në mercaton e verës duke afuar lojtarë si Timo Werner apo Haverts por, me sa duket, nuk e kanë ndërmend të ndalen këtu.



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.  
HYDRO-ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.  
VODOPRIVREDNO PREDUZECE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bil Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Klinton" Br.13 Priština, Kosovo  
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: [info@iber-lepenc.org](mailto:info@iber-lepenc.org)

Ndërmarrja Hidroekonomike, "Ibër-Lepenc" SH.A. –Prishtinë, publikon këtë:

## KONKURS

### 1. Asistente Administrative e Drejtorit të Departamentit të Administratës (1)

#### Detyrat dhe përgjegjësítë do të jenë si vijim:

- Pranon thirje telefonike;
- Kujdeset përfurnizim me kohë me material shpenzues;
- Mban evidencën e shpenzimeve të Drejtorit për reprezentacion;
- Kujdeset përgatitjen me kohë të materialeve të Drejtorit si hartimi, përkthimi, shumëzimi, arkivimi, shpërndarja etj;
- Kujdeset përmirësuarit përgatësish kushtet higjeniko-teknike të zyrës së Drejtorit;
- Kryen edhe punët tjera sipas kërkesës së Drejtorit, të cilat për nga natyra i përgjigjen këtyre detyrave të punës;
- Për punën e tij/ saj i përgjigjet Drejtorit të Administratës.

#### Kushtet:

- Përgatitja e mesme shkollore;
- Përvaja e punës 1 (një) vit;

**Marrëdhënia e punës:** Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimit .

### 4. Referent i dokumentacionit teknik të objekteve (1)

#### Detyrat dhe përgjegjësítë do të jenë si vijim:

- Arkivon, klasifikon dhe ruan dokumentacionin teknik;
- Rregullon dhe ruan dokumentacionin sipas përbajtjeve karakteristike;
- Mban registrat adekuat të dokumentacionit;
- Merr pjesë në hartimin e dokumentacionit teknik të ri;
- Kryen edhe punët tjera, të cilat i përgjigjen përgatitjes shkollore dhe aftësive të fituara në punë;
- Për punën e vet e raporton dhe përgjigjet Shefit të Shërbimit dhe Menaxherit të Nj. Afariste "Uji dhe Gjenerimi".

#### Kushtet:

- Përgatitja e mesme shkollore;
- Njohuri e programeve kompjuterike;
- Përvojë pune në profesion prej së paku 1 (një) vit.

**Marrëdhënia e punës:** Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimit .

#### Kërkesës për pozitat e kërkua të bashkëngjitet:

- CV;
- Diploma e noterizuar;
- Vërtetimin e përvjës së punës;
- Ekstraktin e lindjes;
- Certifikata që nuk është nën hetime;
- Fotokopja e letër njofitimit;

Aplikacionet mund të merren në web-faqen zyrtare të Ndërmarrjes [www.iber-lepenc.org](http://www.iber-lepenc.org).

**Aplikacionet e plotësuarë së bashku me kopje të dëshmive të kërkua sipes konkursit dorëzohen në Drejtorinë Qëndrore të N.H., "Ibër-Lepenc" – Prishtinë ose përmes postës.**

Afati i fundit përdorëzimin e aplikacioneve është 15 ditë nga dita e publikimit.

Aplikacionet e dorëzuar pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen me kandidatin e zgjedhur do të nënshkruhet Kontrata e punës pas sjelljes së certifikatës mjekësore.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESSIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOLBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION



Nr. 08/1  
Dt. 10.02.2021

## KONKURS

### PËR REGJISTRIMIN ENXËNËSVE PËR VITIN SHKOLLOR 2020/2021 KLASËT E 10-TA PËR VIJUES NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË PROFESSIONAL – MESIMI PER TE RRITUR

Për plotësimin e vendeve të lira regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë(10) në Shkollën Qendra e Kompetencës në Prizren, **shpallim këtë drejtum:**

Ekonomi	1 Nëpunës Marketingu	1 Paralele	24 nxënës
---------	----------------------	------------	-----------

#### 1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rrugët

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, përvijumin e mësimit për të rritur në shkolla profesionale, përvitin shkollor 2020/2021, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshmë dhe qe janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jaftë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

#### 2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të të shkollave profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:  
Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkuron)  
Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe Certifikatën e lindjes.

#### 1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitura e dokumenteve, bëhet 15 ditë nga dita e shpalljes. Dorëzimi i dokumenteve bëhet në lokalet e shkollës Qendra e Kompetencës në Prizren, nga ora 9:00-15:00.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Alban Susuri shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Naim Frashëri" Vlashnje.
- Muharem Duraku shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Bajram Curri" Krushe e Madhe.
- Etnik Omaj shpall të pavlefshme dëftesat certifikatën diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- Jap banesë me qira afér 60 m2, katë III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplekt, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhamet Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, katë dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhamet Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, katë dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



A large portrait of a smiling man in a dark suit and blue patterned tie. To his right, the text '#PDK134' is displayed in large blue letters. Below this, a large blue square contains the number '1'. To the right of the man, the name 'Enver HOXHAJ' is written in large blue letters. At the bottom left, a blue banner contains the text '#Rimëkëmbje' in white, with 'PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS' in smaller white text below it.



A portrait of a bald man in a dark suit and dark tie. Behind him is a blurred background featuring the colors red, blue, and yellow, along with a white star. To the right, the text '121 NISMA SOCIALDEMOKRATE' is displayed, with '121' in orange and 'NISMA' in purple. Below this, the text 'ME ÇLIRIMTARËT!' is written in large purple letters, with '11' in orange at the bottom left. To the right of the main text, the name 'BEKIM BRESTOVCI' is written in white on a purple background.

A portrait of Hisen Berisha, a man with grey hair, wearing a dark suit and light blue shirt, smiling. To his right is political campaign text.

#PDK134

*Hisen*  
**BERISHA 53**

**#Rimëkëmbje**  
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS



Prof. Asoc. Dr.  
**SHKELQIM**  
**MILLAKU**  
**54**

**RAMUSH**  
2021  
PËR PRESIDENT

\* \* \* \* \*  
**FORCA E KOSOVËS**



ALIANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS  
ALLIANCE FOR THE FUTURE OF KOSOVO



A portrait of a man with grey hair, wearing a dark blue suit, white shirt, and red patterned tie. He is smiling slightly. To his right, the text '#PDK134' is displayed in large blue letters. Below him, the text 'Ramë VATAJ' is written in blue, with '25' in large white numbers next to it. At the bottom, a blue banner contains the text '#Rimëkëmbje' in white, with 'PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS' in smaller white text below it.



A portrait of a woman with blonde hair, wearing a black turtleneck, a white blazer, and a black necklace. To her right, the text '#PDK134' is displayed in large blue letters. Below her, the number '69' is shown in large white digits inside a blue square. To the right of the number, the text 'Safete MALIQI QORMEMETI' is written in large blue letters. At the bottom, a blue banner contains the text '#Rimëkëmbje' in white, with 'PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS' in smaller white text below it.



#PDK134

**83**

Bujar  
KUKLECI

#Rimëkëmbje

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS



LDK

# Shteti. Shtet.

44

Jetlir  
Zyberaj



#PDK134

**8** Bajrush  
Xhemaili

#Rimëkëmbje

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS



127

SHQIPE MEHMETI SELIMI

10

#krejtdhedrejt

ROYAL CROWN:  
**RC** cola

ANNOUNCING THE 2017  
QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients  
(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A. Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L Lebanon, Sales
- ★ Kofola CeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Parlex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

Columbus, Georgia, USA

